



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E INDUSTRIË, NDËRMARRËSISË
DHE TREGTISË



VLERËSIMI

i Planit të Veprimit 2023-2025

të Strategjisë së Kosovës për Zhvillimin e

Industrië dhe Mbështetjen e Bizneseve

2030

Përgatitur nga:
GPI Global Policy Incubator GmbH

Data: 12 nëntor 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|---|-----------|
| 1. HYRJE | 4 |
| 1.1. Informata të përgjithshme rreth politikës industriale | 4 |
| 1.2. Konteksti dhe qëllimi i këtij vlerësimi..... | 5 |
| 2. METODOLOGJIA DHE QASJA E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE | 6 |
| 2.1. Përshkrim i qasjes me metoda të përziera | 6 |
| 2.2. Pasqyrë e burimeve të shfrytëzuara të të dhënave | 10 |
| 3. PROGRESI DREJT OBJEKTIVAVE TË POLITIKËS INDUSTRIALE | 11 |
| 3.1. Pasqyrë e performancës së industrisë në krahasim me Objektivat Strategjike | 11 |
| 3.2. Pasqyrë e arritjes së Objektivave Specifikë..... | 14 |
| 4. VEPRIMET E POLITIKËS: STATUSI I ZBATIMIT DHE KONTRIBUTI NË OBJEKTIVAT E SZHIMB-SË | 21 |
| 4.1. Statusi i zbatimit dhe faktorët shtytës..... | 21 |
| 4.2. Aktivitetet dhe kontributi në objektivat e politikës industriale | 27 |
| 5. ANALIZA TË THELLUARA TË LOGJIKËS SË NDËRHYRJES DHE AKTIVITETEVE TË PËRZGJEDHURA | 35 |
| 5.1. Krijimi i Qendrës Kombëtare për Çertifikimin e Produkteve..... | 35 |
| 5.2. Zgjerimi i dritares së eksportit në Fondin Kosovar për Garanci Kreditore | 39 |
| 5.3. Krijimi i një programi të punësimit në prodhimtari në kuadër të Masave Aktive të Tregut të Punës | 41 |
| 5.4. Mësimet nga tri analiza rreth mënyrës se si mund të adresohet deficitit tregtar në industri | 43 |
| 6. PËRMBLEDHJE DHE PËRFUNDIME | 45 |
| 7. SHTOJCA | 49 |
| Shtojca 1: Analiza shtesë rreth progresit drejt Objektivave Strategjike | 49 |
| Shtojca 2: Rekomandime rreth vazhdimit ose ndërprerjes së Instrumenteve të Politikës në Planin e Veprimit 2023-2025 | 53 |

LISTA E FIGURAVE

| | |
|---|----|
| Figura 1: Objektivat strategjike dhe performanca e treguesve kryesorë (ndryshimi i përqindjes krahasuar me vitin 2022)..... | 12 |
| Figura 2: Ndryshimi i përqindjes në treguesit që e masin performancën e nxitësve të performancës së parakushteve industriale mes viteve 2022 dhe 2024..... | 16 |
| Figura 3: Vlerësimi i rëndësisë mesatare sipas statusit të zbatimit | 24 |
| Figura 4: Statusi i zbatimit të veprimeve të politikës në të gjithë objektivat strategjike (në %)..... | 27 |
| Figura 5: Madhësia dhe rëndësia e pakove të politikave në të gjithë objektivat strategjike | 29 |
| Figura 6: Shkalla e arritjes së targeteve për 2026 dhe 2030 për TKP-të që i masin Objektivat Strategjike (në % e dallimit mes vlerave të targetuara dhe vlerave referente)..... | 50 |
| Figura 7: Shkalla e arritjes së targeteve të normalizuara për 2030 për TKP-të që i masin Objektivat Strategjike (në % e dallimit mes vlerave aktuale dhe vlerave të pritura për vitin 2024) | 52 |

LISTA E TABELAVE

| | |
|--|----|
| Tabela 1: Progresi në fushat e ndërhyrjes në të gjithë objektivat strategjike | 15 |
| Tabela 2: Statusi i zbatimit të veprimeve të politikës në Planin e Veprimit 2023 - 2025 | 23 |
| Tabela 3: Statusi i zbatimit të veprimeve të politikës dhe burimi i financimit të tyre | 23 |
| Tabela 4: Pengesat kryesore ndaj zbatimit të veprimeve të planit të veprimit (bazuar në përgjigjet nga anketa me palët e interesit)..... | 25 |
| Tabela 5: Vlerësimi i koherencës mes performancës në fushat e ndërhyrjes dhe statusit të zbatimit të veprimeve të planifikuara të politikës | 30 |
| Tabela 6: Statusi i zbatimit të veprimeve të politikës në fushën e ndërhyrjes 2.3 "Zëvendësimi i importit të produkteve të ndërmjetme dhe përfundimtare me prodhime vendor dhe promovimi i produkteve vendorë" | 33 |
| Tabela 7: Statusi i zbatimit të veprimeve të politikës në Objektivin Specifik 1.4 "Rritja e cilësisë dhe certifikimit të produkteve të njohura ndërkombëtarisht" | 36 |
| Tabela 8: Statusi i zbatimit të veprimeve të politikës në Objektivin Specifik 2.1 "Mbështetja e ndërmarrjeve për shfrytëzimin e potencialit të tyre për eksport" | 39 |
| Tabela 9: Statusi i zbatimit të veprimeve të politikës në Objektivin Specifik 3.1 "Ngritja e kualifikimit dhe certifikimit të fuqisë punëtore teknike dhe menaxherëve të ndërmarrjeve" | 41 |

1.

HYRJJE

1.1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME RRETH POLITIKËS INDUSTRIALE

Strategjia për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Bizneseve (SZHIMB) 2030 — e referuar më poshtë si "Politika Industriale" — është hartuar nga Qeveria e Kosovës (QK) për të krijuar një kornizë strategjike që synon përshpejtimin e zhvillimit industrial. Krijimi i kësaj politike nënvizon njohjen e sektorit të prodhimit nga QK si nxitës kyç për transformimin strukturor të ekonomisë së Kosovës. Vizioni i saj afatgjatë është i qartë: deri në vitin 2030, industria e Kosovës duhet të evoluojë në një sektor të integruar globalisht, të aftë për të prodhuar mallra me vlerë të lartë të shtuar dhe për të gjeneruar punësim të denjë.

Metodologjia e përdorur në hartimin e Politikës Industriale, e njohur si Përmirësimi i Cilësisë së Politikave Industriale (EQUIP)¹, ka ofruar një qasje të strukturuar të bazuar në analizën diagnostikuese. Logjika e ndërhyrjes që e mbështet politikën është ndërtuar përmes një procesi me katër hapa: përafrimi me objektivat strategjike të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim (SKZH 2030), formulimi i objektivave të synuara të politikave, identifikimi i boshllëqeve të shkathtësive në peizazhin industrial të Kosovës dhe përkthimi i këtyre boshllëqeve në nën-objektiva të zbatueshme që e përbëjnë planin më të gjerë të veprimit. Analiza është përdorur për diskutime të brendshme qeveritare dhe për konsultime me palët e interesit, të cilat në fund rezultuan në formulimin e pesë objektivave strategjike të mëposhtëm:

- Objektivi Strategjik 1. Zgjerimi i prodhimit industrial
- Objektivi Strategjik 2. Reduktimi i deficitit tregtar industrial
- Objektivi Strategjik 3. Gjenerimi i punësimit më të mirë dhe gjithëpërfshirës
- Objektivi Strategjik 4. Lehtësimi i industrisë së gjelbër dhe qarkore
- Objektivi Strategjik 5. Maksimizimi i rritjes së vlerës së brendshme

Pesë objektivat strategjike mbështeten nga gjashtëmbëdhjetë objektiva specifike (që i përfaqësojnë gjashtëmbëdhjetë fusha të ndërhyrjes)² dhe shtatëdhjetë e dy veprime

¹ Shih www.equip-project.org për më shumë informata rreth qasjes.

² Dokumenti i SZHIMB 2030 i përcakton si në vijim: "Objektivat specifike mund të konsiderohen si parakushte ose shtytës për arritjen e arritjen e një objektivi të caktuar të politikës industriale. (...) Identifikimi i objektivave specifike është bazuar në

(d.m.th. instrumente të politikës të përdorura për t'i nxitur dhe arritur ndryshimet e dëshiruara) që së bashku e përcaktojnë Politikën Industriale të Kosovës 2030. Ato janë nxjerrë nga një vlerësim gjithëpërfshirës i performancës ekonomike, sociale dhe mjedisore të sektorit të prodhimit.

Suksesi i Planit të Veprimit 2023–2025 varet nga zbatimi i koordinuar, vullneti i qëndrueshëm politik dhe partneritetet e fuqishme mes Qeverisë së Republikës së Kosovës, palëve të interesit nga sektori privat dhe akterëve ndërkombëtarë zhvillimorë. Një kuptim i përbashkët i sfidave dhe mundësive industriale të Kosovës është thelbësor për realizimin e ambicieve transformuese të politikës.

1.2. KONTEKSTI DHE QËLLIMI I KËTIJ VLERËSIMI

Ky vlerësim zhvillohet dy vjet pas publikimit të Planit të Veprimit 2023-2025 të Politikës Industriale të Kosovës 2030. Ai shërben për ta vlerësuar shkallën në të cilën faza fillestare e zbatimit ka hedhur themelet për arritjen e qëllimeve afatgjata të Politikës Industriale. Qëllimi i këtij vlerësimi është i dyfishtë:

- Vlerësimi i progresit drejt pesë objektivave kryesore të politikaës: (1) zgjerimi i prodhimit industrial, (2) zvogëlimi i deficitit tregtar në mallrat industriale, (3) nxitja e punësimit gjithëpërfshirës dhe të denjë, (4) promovimi i industrisë së gjelbër dhe (5) maksimizimi i rritjes së vlerës së brendshme.
- Kuptimi i shkallës në të cilën masat e politikave të listuara në Planin e Veprimit janë zbatuar dhe kanë kontribuar në arritjen e objektivave specifike dhe, më pas, objektivave strategjike.

vlerësimin e kapaciteteve industriale të Kosovës, i cili përfshin faktorë të ndryshëm, si infrastruktura, financat dhe niveli i aftësive të punëtorëve".

2.

METODOLOGJIA DHE QASJA E MBLLEDHJES SË TË DHËNAVE

2.1. PËRSHKRIMI I QASJES ME METODA TË PËRZIERA

Për këtë vlerësim është përdorur një qasje me metoda të përziera. Më konkretisht, për ta vlerësuar Planin e Veprimit 2023-2025 të Strategjisë për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Bizneseve (SZHIMB) 2030, metodologjia mbështetet në analizën e të dhënave sasiore dhe cilësore dhe përqendrohet në logjikën e ndërhyrjes të përcaktuar në SZHIMB 2030.


SZHIMB 2030 e ka përcaktuar një logjikë të ndërhyrjes që e përkufizon Planin e Veprimit dhe ka tri shtresa kryesore, si në vijim:



Në terminologjinë tradicionale të Monitorimit dhe Vlerësimit (M&V), termat e mësipërm mund të shoqërohen me termet në vijim:

- Veprimet apo “aktivitetet” (apo “produktet”)
- Objektivat specifike apo “rezultatet”
- Objektivat strategjike apo “ndikimi”

Siç është përcaktuar në Planin e Veprimit, progresi në secilin prej 5 objektivave strategjike matet me një ose dy tregues kryesorë sasiore të performancës (TKP) dhe secili prej 16 objektivave specifike matet me një grup prej 1 deri në 4 treguesish. Plani i Veprimit po ashtu përcakton objektiva specifike sasiore për secilin prej këtyre TKP-ve: objektiva afatmesëm për vitin 2026 dhe objektiva përfundimtarë për vitin 2030. Ndërkohë, veprimet monitorohen rregullisht në dimensione të ndryshme, siç është statusi i zbatimit të tyre. Logjika e përgjithshme e ndërhyrjes mund të paraqitet si më poshtë:



Vlerësimi realizohet në tre hapa kryesor:

Hapi 1. Analiza e progresit të industrisë drejt pesë objektivave strategjikë, e matur nga ndryshimi në përqindje në treguesit kryesorë të performancës (TKP) mes vitit 2022, që është vlera referente për zbatimin e Planit të Veprimit, dhe vitit 2024, që është pika më e fundit e të dhënave³. Kjo na ndihmon t'i përgjigjemi pyetjes: *A kanë lëvizur TKP-të në drejtimin e duhur?* Vlerat e TKP-ve na mundësojnë ta klasifikojmë edhe performancën e industrisë në lidhje me secilin objektiv strategjik në tri kategori:

- **Duke u përmirësuar.** Treguesi(t) që e masin objektivin strategjik po tregojnë trende pozitive.
- **Duke u përmirësuar pjesërisht.** Disa tregues që e masin objektivin strategjik janë duke u përmirësuar ndërsa të tjerët janë duke ngecur ose duke shfaqur trend negativ.
- **Duke u përkeqësuar.** Treguesi(t) që e masin objektivin strategjik po shfaqin trende negative.

Ky kategorizim përbën bazën për analizën e korrelacionit ndërmjet "nivelit të ndikimit" (domethënë, ndryshimeve në performancën industriale duke pasur parasysh Objektivat Strategjikë të politikës) dhe "nivelit të rezultatit" (domethënë, ndryshimeve në parakushtet industriale, faktorët mundësues dhe aftësitë në fushat kryesore të ndërhyrjes, të parapara me Objektivat Specifikë të logjikës së ndërhyrjes. Me fjalë të tjera, analiza e zhvillimeve në fushat e ndryshme të ndërhyrjes, e cila do të pasojë në hapin tjetër, do të na lejojë t'i identifikojmë (i) korrelacionet e mundshme mes progresit në çdo objektiv strategjik të

³ Për vlerësim më të hollësishëm, Shtojca ofron analiza shtesë bazuar në përqindjen e arritjes së vlerave të targetuara për vitin 2026 dhe 2030. Kjo na mundëson t'i përgjigjemi pyetjes: *Sa është arritur progress në TKP-të drejt caqeve për vitin 2026 dhe 2030 në krahasim me vlerat referente të vitit kur është vendosur caku?* Për ta thelluar vlerësimin edhe më shumë, Shtojca po ashtu raporton rezultatet për një tregues indirekt që e mat shpejtësinë e progresit, duke e adresuar pyetjen vlerësuese: *A ka qenë progresi i shpejtë sa duhet për t'i arritur caqet për vitin 2030 me kohë (me supozimin se progresi është linear)?* Rezultatet nga analizat plotësuese janë përfshirë në tekst aty ku është konsideruar e nevojshme.

caktuar nga njëra anë dhe (ii) arritjeve në fushat e ndërhyrjes të cilat janë përcaktuar për ta mbështetur atë nga ana tjetër.

Hapi 2. Analiza e treguesve sasiorë të performancës të shoqëruar me secilën fushë të ndërhyrjes, ku progresi matet me ndryshimin e përqindjes në treguesit e përcaktuar për secilin objektiv përkatës specifik.

Ky hap na mundëson ta klasifikojmë performancën e secilit objektiv specifik në tri kategori:

- **Duke u përmirësuar.** Treguesi(t) që e masin objektivin specifik po shfaqin trende pozitive.
- **Duke u përmirësuar pjesërisht.** Disa tregues që e masin objektivin specifik janë duke u përmirësuar ndërsa të tjerët janë duke ngecur ose duke shfaqur trend negativ.
- **Duke u përkeqësuar.** Treguesi(t) që e masin objektivin specifik po shfaqin trende negative.

Ky kategorizim përbën bazën për analizën e korrelacionit ndërmjet “nivelit të rezulttit” dhe “nivelit të produktit” (që përbëhet prej veprimeve të ndryshme të politikës) të logjikës së ndërhyrjes. Domethënë, vlerësimi i shkallës së zbatimit të të gjitha “Veprimeve” të shoqëruara me secilin objektiv specifik, që do të realizohet në hapin e radhës, do të na mundësojë t’i identifikojmë korrelacionet e mundshme ndërmjet aktiviteteve që janë zbatuar (ose kanë filluar) dhe progresit të shënuar drejt arritjes së objektivave specifike në të cilët pritet të shpiejnë.

Hapi 3. Analiza mbështetet në statusin e zbatimit të secilit veprim të politikës⁴ sipas tri kategorive:

- **I zbatuar.** Të gjitha aktivitetet e parapara me veprimin e politikës janë zbatuar plotësisht në kohën e vlerësimit.
- **I zbatuar.** Disa por jo të gjitha aktivitetet e parapara me veprimin e politikës janë zbatuar në kohën e vlerësimit.
- **Nuk është zbatuar ende.** Asnjë aktivitetet nuk kishte filluar në kohën e vlerësimit.

Një analizë shtesë cilësore është realizuar për t’i kuptuar faktorët shtytës të statusit të zbatimit, rëndësinë e secilit veprim si dhe dëshmitë e mundshme të ndikimit. Sa i përket pikës së dytë, për secilin veprim të politikës është nxjerrë një “vlerësim i rëndësisë”, sipas kësaj metodologjie: Tri llojeve të palëve të interesit iu është kërkuar ta vlerësojnë (sipas njohurive të tyre megjithë në mënyrë subjektive) rëndësinë e secilit veprim, duke i dhënë një notë në shkallën prej 1 (jo e rëndësishme) deri në 10 (shumë e rëndësishme). Tri grupet e palëve të interesit ishin:

- Grupi për Monitorimin e Politikës Industriale (i përbërë prej përfaqësuesve të institucioneve të ndryshme që janë palë të interesit të përfshirë në zbatimin e SZHIMB-së 2030)⁵

⁴ Rikujtojmë që një veprim i politikës zakonisht përfshin jo një por disa aktivitete që duhet të zbatohen. Për ta ilustruar me një shembull, mendoni një masë legjislative apo rregullative e cila, për shembull, përfshin hartimin e një ligji, realizimin e konsultimeve në lidhje me draftin, dorëzimin e projektligjit të rishikuar në parlament, miratimin e ligjit, etj. Prandaj, këtu nuk do t’i përdorim termet “aktivitet” dhe “veprim” si sinonime por një “veprim” i politikës duhet të mendohet si përfaqësim i një grupi të shumë “aktiviteteve”.

⁵ Vlerësimin e tyre e kanë dhënë në kontekstin e një punëtorie me të cilën ka filluar vlerësimi dhe që është mbajtur më 2-3 gusht 2025.

- Pjesëmarrësit në një anketë elektronike që është përgatitur nga ekipi vlerësues për të mbledhur informata rreth zbatimit të veprimeve të politikës (shih më poshtë për më shumë detaje)
- Ekspertët e GPI-së.

Rezultatet fillimisht janë ndarë brenda secilit grup për ta nxjerrë mesataren për grup. Pastaj, këto mesatare nga vlerat e tri grupeve janë analizuar përsëri për ta nxjerrë mesataren në mënyrë që të nxjerret vlerësimi përfundimtar për rëndësinë e secilit veprim. Prandaj, secili grup bart peshën e njëjtë.

Së fundmi, për ta kuptuar më mirë funksionimin e instrumenteve specifike të politikës që synojnë adresimin e prioriteteve kryesore të politikës dhe për t'i identifikuar faktorët e përbashkët që e përcaktojnë efektivitetin e tyre, ky vlerësim thellohet në tri veprime të zgjedhura të politikës. Analizimi i efektivitetit të këtyre veprimeve do të ndihmojë edhe në përcaktimin e pengesave horizontale në sektorët kryesorë dhe mundësuesit e nevojshëm për performancën e përgjithshme industriale. Tri veprimet e politikës që janë përfshirë në "thellimin" e tillë janë përzgjedhur bazuar në katër elemente kryesore:

- Instrumentet e politikës të cekura si prioritet në kapitullin 7 të SZHIMB-së dhe në preambulën e Planit të Veprimit⁶
- Nëse veprimi i politikës është zbatuar tashmë (të paktën pjesërisht)
- Rëndësia e veprimit të politikës
- Aftësia për t'i përcjellur treguesit për ta matur progresin në objektivat e ndërlidhur specifike dhe strategjike.

Tri veprimet e mëposhtme të politikës janë zgjedhur për analizën e thelluar:

- Veprimi 1.4.1. Krijimi i Qendërs Kombëtare për Certifikimin e Produkteve
- Veprimi 2.1.1. Zgjerimi i dritares së eksportit në kuadër të Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK)
- Veprimi 3.1.4. Krijimi i një programi të punësimit në sektorin prodhues në kuadër të Masave Aktive të Tregut të Punës

Secila prej këtyre tri veprimeve ka për qëllim të kontribuojë në një objektivi tjetër strategjik dhe analiza do të ofrojë më shumë të dhëna rreth pengesave dhe mundësive në nxitjen e progresit në fushat përkatëse të ndërhyrjes.

⁶ Dhjetë nga 75 veprimet e politikës janë theksuar në dokumentin e politikës industriale dhe në Planin e Veprimit si esenciale për të siguruar që vizioni i politikës industriale (domethënë, i krijimit të një industrie të integruar globalisht që është në gjendje të prodhojë produkte me vlerë të lartë të shtuar dhe të ofrojë punësim të dinjitetshëm) do të materializohet. Këto veprime me prioritet përfshijnë mbështetjen e themelimit të parqeve moderne industriale me tipare ekologjike për të tërhequr investime dhe për ta lehtësuar bashkëpunimin horizontal dhe vertikal ndërmjet kompanive; krijimin e një qendre kombëtare për certifikimin e produkteve për ta përshpejtuar qasjen në tregje ndërkombëtare, duke përfshirë mbështetjen e trupave të vlerësimit të konformitetit; zgjerimin e Instrumentit të Financimit të Eksportit në Fondin e Kosovës për Garanci Kreditorë (FKGK) për ta përmirësuar qasjen në financa për prodhuesit e orientuar në eksport; përmirësimi i regjimit të tarifave të importit për mallra të caktuara në prodhimtari për ta ulur varësinë e lartë nga furnizuesit e huaj dhe lënda e parë e importuar; zbatimin e një programi të punës në prodhimtari që e kombinon subvencionimin e pagave dhe punën praktike në kompani për ta adresuar nivelin e lartë të papunësisë në mesin e grupeve të cenueshme; krijimin e një skeme kreditore për shkathtësitë për t'i avancuar shkathtësitë në mesin e fuqisë punëtore për angazhim më të madh dhe më të mirë në sektorin e prodhimit; përkrahjen e investimeve të shtuara në teknologjitë e gjelbra duke i kombinuar kreditë dhe grantet për përmirësimin e efikasitetit dhe digjitalizimit; përmirësimin e legjislacionit në prokurimin publik për të ofruar lehtësira për produktet vendore dhe të gjelbra; dhe ofrimin e lehtësirave tatimore për investime në inovacionin në prodhim për të nxitur më shumë inovacion drejt produkteve me vlerë të lartë të shtuar.

2.2. PASQYRË E BURIMEVE TË SHFRYTËZUARA TË TË DHËNAVE

Mbledhja e të dhënave për këtë vlerësim është realizuar nga mesi i muajit korrik 2025 deri në fillim të muajit shtator 2025. Vlerësimi mbështetet në dy lloje kryesore të të dhënave:

- Të dhëna parësore.
- Të dhëna dytësore.

Të dhënat parësore janë mbledhur përmes mënyrave dhe mjeteve të ndryshme:

- Konsultime me palët e interesit duke përfshirë punëtoritë në fillim të muajit gusht 2025 dhe në fillim të muajit shtator 2025 dhe intervistat gjysmë të strukturuar në fillim të muajit shtator 2025.
- Një anketë elektronike e cila është ndarë me anëtarët e Grupit Monitorues të Politikës Industriale nga data 7 gusht 2025 deri më 6 shtator 2025.

Gjithsej, dy punëtori, shtatëmbëdhjetë intervista të thelluara dhe një anketë elektronike na kanë mundësuar të mbledhim informata rreth elementeve të ndryshme siç është statusi i zbatimit të veprimeve të politikës, ndikimi i mundshëm dhe faktorët e ndikimit të jashtëm. Informatat e mbledhura janë plotësuar me analiza të dokumenteve, duke përfshirë rishikimin e dokumenteve të politikave dhe rasteve studimore.

Të dhënat dytësore janë mbledhur nga MINT dhe kanë ardhur qoftë nga burimet zyrtare vendore, duke përfshirë Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Departamentin e Doganës, ose nga organizatat ndërkombëtare. Qëllimi kryesor i tyre ka qenë llogaritja e TKP-ve për objektivat strategjike dhe specifike.

3.

PROGRESI DREJT OBJEKTIVAVE TË POLITIKËS INDUSTRIALE


3.1. PASQYRË E PERFORMANCËS SË INDUSTRISE NË KRAHASIM ME OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

Ky kapitull shtjellon nivelin e progresit të arritur drejt secilit objektiv strategjik të politikës industriale. Kjo është bërë duke e llogaritur ndryshimin e përqindjes në një apo dy tregues kryesorë të performancës që është përcaktuar për çdo objektiv strategjik në Planin e Veprimit 2023-2025. Duke vlerësuar nëse këta TKP kanë lëvizur në drejtimin e duhur, arrijmë të kuptojmë nëse industria e Kosovës e ka përmirësuar performancën e saj që nga lansimi i Planit të Veprimit.

Figura 1 paraqet ndryshimin e përqindjes në secilin prej shtatë TKP-ve me objektivin përkatës strategjik poshtë tyre. Për ta lehtësuar interpretimin e gjetjeve, rezultatet janë paraqitur me këto kode të ngjyrave:

- Rubrikat dhe kutitë me ngjyrë të gjelbër të errët paraqesin ndryshim pozitiv: përmirësim në një tregues apo objektiv strategjik.
- Kutitë me ngjyrë të gjelbër të hapur paraqesin ndryshim me trende të përziera: përmirësim i pjesërishëm në një objektiv strategjik.
- Elementet me ngjyrë të kuqe paraqesin ndryshime negative në një tregues apo objektiv strategjik.

Figura 1: Objektivat Strategjike dhe performanca e treguesve kryesorë (ndryshimi i % krahasuar me vitin 2022).



Këta shtatë tregues janë zgjedhur nga QK për ta matur performancën e industrisë së Kosovës sa i përket pesë objektivave strategjike të Planit të Veprimit. Një tregues tregon trend negativ ndërsa gjashtë tregues shfaqin trende pozitive. Si rezultat, **katër objektiva strategjike shfaqin përmirësim, ndërsa një përkeqësim.**

Pjesa tjetër e këtij nënkapitulli shpjegon hollësisht performancën e industrisë së Kosovës karshi të gjithë objektivave strategjike dhe mënyrën se si nxitet nga treguesi(t) kryesorë që e masin performancën e tyre.

- 1. Zgjerimi i prodhimit industrial.** Në këtë aspekt ka pasur përmirësim. Së pari, kapaciteti i vendit për të gjeneruar vlerë të shtuar (VSHP) në prodhim është përmirësuar dhe TKP (VSHP për kokë banori në EUR) është rritur prej më shumë se 27% (nga 643 në vitin 2022 në 820 në vitin 2024)⁷. Së dyti, rëndësia e sektorit për ekonominë e Kosovës është rritur pak mes viteve 2022 dhe 2024, ku kontributi i sektorit të prodhimit në produktin e brendshëm bruto (domethënë VSHP/BPV) është rritur me 2.5% (nga 12.8% në 13.1%). Kjo sugjeron që sektori i prodhimit është rritur me një ritëm pak më të shpejtë se sektorët e tjerë, me një kontribut në rritje në rritjen ekonomike. Konsultimet me palët e interesit kanë vënë në pah se, duke pasur parasysh madhësinë e vogël të tregut të brendshëm, Kosova duhet të përqendrohet në arritjen e tregjeve të reja dhe fitimin e pjesëve të reja të tregut për ta zgjeruar më tej prodhimin industrial.
- 2. Reduktimi i deficitit tregtar industrial.** Pavarësisht se reduktimi i tij është objektiv strategjik, deficitit tregtar i prodhimit është rritur për 4.1% mes viteve 2022 dhe 2024. Më konkretisht, nga -4,718.9 milionë euro në vitin 2022 është rritur në -4,916.3 milionë euro

⁷ Është e rëndësishme të ceket që Regjistrimi i Popullsisë në vitin 2024 zbuloi një mbivlerësim të rëndësishëm të numrit të popullsisë dhe rënja e numrit zyrtar të popullsisë nga viti 2022 në vitin 2024 mund të ketë ndikuar në rezultate.

në vitin 2024 dhe po bëhet një sfidë në rritje për Kosovën. Ky është i vetmi objektiv strategjik që tregon trend të qartë negativ dhe duhet të adresohet si prioritet. Si rritja e eksportit ashtu edhe rënja e importit të mallrave të ndërmjetme të prodhimit mbeten detyra të rëndësishme për Kosovën dhe vendi është shumë i ndjeshëm ndaj goditjeve të jashtme. Diskutimet me palët e interesit kanë nxjerrë në pah varësi të qarta strukturore nga lënda e parë e huaj për prodhim, të cilat duhet të adresohen për të mos e rritur më tej deficitin tregtar industrial. Analiza e performancës mbi objektivat specifike ose "fushat e ndërhyrjes" do të ofrojë njohuri mbi përcaktuesit kryesorë të këtyre rezultateve.

- 3. Gjenerimi i punësimit gjithëpërfshirës dhe të dinjitetshëm.** Rezultatet shfaqin trende pozitive në gjenerimin e punësimit gjithëpërfshirës dhe të dinjitetshëm. Më konkretisht, dy treguesit që e masin performancën e industrisë në këtë objektiv strategjik shfaqin ndryshime pozitive që nga viti 2022: Punësimi për kokë banori në prodhim është rritur për 19% nga viti 2022 deri në vitin 2024, ndërsa pjesëmarrja e pagave në prodhim në VSHP është rritur për 22% gjatë së njëjtës periudhë. Këto rezultate tregojnë jo vetëm se sektori i prodhimit po krijon mundësi gjithnjë e më të mëdha punësimi, por edhe se këto mundësi po bëhen më tërheqëse. Këto vëzhgime janë në përputhje me kontributet e marra nga palët e interesit gjatë konsultimeve: brezat e rinj tani po i perceptojnë vendet e punës në prodhim si më fitimprurëse sesa në të kaluarën dhe të rinjtë janë gjithnjë e më të gatshëm të marrin arsim teknik në krahasim me diplomat e përgjithshme.
- 4. Lehtësimi i industrisë së gjelbër dhe qarkore.** Përpjekjet për promovimin e industrisë së gjelbër dhe qarkore kanë sjellë përmirësime të lehta. Më konkretisht, intensiteti i emetimeve të proceseve të prodhimit (i matur si kg emetime të CO₂ për USD të VSHP-së në terma të Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPP)) ka rënë për 3,5% (nga 0.58 në 0.56). Ky përmirësim është inkurajues, por për ta arritur objektivin e vitit 2030 prej 0.27 kg emetimesh të CO₂ për USD të VSHP-së, emetimet do të duhet të ulen dy herë më shpejt. Për më tepër, për shkak të varësisë së Kosovës nga eksportet për rritje, lehtësimi i industrisë së gjelbër dhe qarkore po bëhet po ashtu gjithnjë e më i rëndësishëm pasi që tregjet kryesore të eksportit po vendosin standarde më të larta mjedisore (p.sh. Mekanizmi i BE-së për Rregullimin e Kufirit të Karbonit, CBAM⁸) që kompanitë e Kosovës do të duhet t'i përmbushin për të hyrë në tregje. Në nivel kombëtar, promovimi i ekonomisë qarkore perceptohet si thelbësor. Konsultimet kanë vënë në dukje faktin se Kosova është tepër e varur nga lënda e parë e importuar dhe lënda e parë në prodhim, se mungojnë sisteme efikase të menaxhimit të mbeturinave dhe se mbeturinat e deponive po bëhen shqetësim në rritje që duhet të merret parasysh.
- 5. Maksimizimi i rritjes së vlerës së brendshme.** Mes viteve 2022 dhe 2024 janë shënuar përmirësime të lehta dhe sektori i prodhimit tani po gjeneron më shumë vlerë të shtuar për njësi të prodhimit të prodhuar. Më konkretisht, ndërmjet viteve 2022 dhe 2024, pjesa e VSHP-së në prodhimin u rrit për 1%, duke nënkuptuar se prodhuesit po shtojnë pak më shumë vlerë në lëndën e parë që e përpunojnë dhe transformojnë gjatë proceseve të tyre të prodhimit. Ky zgjerim në shtimin e vlerës mbështetet nga perceptimi i palëve të interesit, të cilët e përmendën gjatë intervistave se firmat

⁸ CBAM është instrumenti kryesor për adresimin e emetimeve të karbonit që përdoret në mallrat e eksportuara në BE.

kosovare tani posedojnë makineri me cilësi të lartë për prodhim në të gjithë sektorët kryesorë (p.sh., dru, metal, etj.). Megjithatë, mbeten pengesa të tjera për maksimizimin e krijimit të vlerës së shtuar, siç është furnizimi i pamjaftueshëm me shkathtësi të mjaftueshme (p.sh. për menaxhimin e linjave të prodhimit) që ua pamundëson kompanive ta shfrytëzojnë potencialin e tyre të plotë të produktivitetit.

3.2. PASQYRË E ARRITJES SË OBJEKTIVAVE SPECIFIKË

Ky nënkapitull analizon se sa është arritur progres që nga publikimi i Planit të Veprimit në objektivat specifike apo "fushat e ndërhyrjes" në kuadër të secilit objektiv strategjik. Një qëllim kyç i këtij nënkapitulli është të identifikohen korrelacionet mes performancës së industrisë në një objektiv të caktuar strategjik dhe progresit të arritur në fushat e ndërlidhura të ndërhyrjes që janë parakushte të përmirësimit të performancës së industrisë.

Për ta bërë këtë, Tabela 1 paraqet korrelacionet e mundshme mes progresit në fusha të ndryshme të ndërhyrjes (domethënë, objektivat specifike) dhe performancës së industrisë (domethënë, objektivat strategjike) duke i hartëzuar objektivat e ndërlidhur (të definuar sipas logjikës së ndërhyrjes të Politikës Industriale)⁹. Për ta lehtësuar identifikimin e korrelacioneve të mundshme, rezultatet janë paraqitur me ngjyrat si në vijim:

- Elementet me ngjyrë të gjelbër të errët paraqesin përmirësim në një objektiv.
- Elementet me ngjyrë të gjelbër të hapur paraqesin përmirësim të pjesshëm në një objektiv.
- Elementet me ngjyrë të kuqe paraqesin përkeqësim në një objektiv.
- Elementet me ngjyrë të zezë nënkuptojnë që nuk ka pasur të dhëna të disponueshme.

Për t'i analizuar rezultatet, lexuesi duhet të vazhdojë në tre hapa. Tabela 1 është esenciale për Hapin 1 dhe Hapin 2, ndërsa Figura 2 paraqet informatat e nevojshme për ta kryer Hapin 3. Tre hapat janë si në vijim:

- **Hapi 1.** Analizoni ngjyrat e të dhënave në kolonën e djathtë të Tabelës 1 për ta kuptuar performancën në një objektiv të caktuar specifik
- **Hapi 2.** Krahasoni këtë me ngjyrat e të dhënave në kolonën e majtë që paraqet korrelacione të mundshme pozitive ose negative ndërmjet arritjeve në një fushë të caktuar të ndërhyrjes dhe progresit drejt objektivit përkatës strategjik.
- **Hapi 3.** Identifikoni faktorët kyç shtytës të rezultateve duke e shikuar performancën e treguesve që i matin fushat e ndërhyrjes.

Hapi 1 dhe Hapi 2 na mundësojnë t'i vëmë re korrelacionet mes performancës së objektivave strategjike dhe objektivave specifike. Me fjalë të tjera, kjo analizon na ndihmon t'i kuptojmë faktorët mundësues, parakushtet ose kapacitetet industriale që mund ta nxisin performancën e industrisë sa i përket objektivave strategjike në të cilët bëjnë pjesë.

⁹ Rikujtojmë që vlerësimi i performancës për secilin objektiv specifik bazohet në ndryshimin e përqindjes në të paktën një tregues (të përcaktuar në planin e veprimit). Shih kapitullin e metodologjisë për më shumë hollësi.

Hapi 3 përbëhet nga një analizë e gjerë e progresit në fushat e ndryshme të ndërhyrjes. Kjo mbështetet në Figura 2 e cila paraqet ndryshimin në përqindje nga viti 2022 deri në vitin 2024 në TKP-të që janë përcaktuar për t'i matur përmirësimet në ata faktorë kyç mundësues, kapacitete dhe parakushte për zhvillimin industrial që janë përkrahur në Objektivat Specifikë të SZHIMB-së 2030. Kjo do të mundësojë që të vihen në pah shtytësit e rezultateve të vërejtura në nivelin e Objektiveve Strategjike.

TABELA 1: PROGRESI NË FUSHAT E NDËRHYRJES NË TË GJITHË OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

| Objektivi Strategjik | Emri i Objektivit të Veçantë |
|--|---|
| 1. Zgjerimi i Prodhimit Industrial | 1.1 Lehtësimi i qasjes në financa për prodhuesit vendas |
| | 1.2 Rritja e investimeve në prodhimtari |
| | 1.3 Përsheptimi i dixhitalizimit në prodhimtari |
| | 1.4 Përmirësimi i cilësisë dhe certifikimit të produkteve të njohura ndërkombëtarisht |
| 2. Reduktimi i deficitit tregtar industrial | 2.1 Mbështetje e ndërmarrjeve për të shfrytëzuar potencialin e tyre për eksport |
| | 2.2 Diversifikimi i tregjeve të eksportit |
| | 2.3 Zëvendësimi i importeve të produkteve ndërmjetëse dhe përfundimtare me prodhim vendas dhe promovimi i produkteve lokale |
| 3. Gjenerimi i punësimit gjithëpërfshirës dhe të denjë | 3.1 Përmirësimi i kualifikimit dhe certifikimit të fuqisë punëtore teknike dhe menaxherëve të ndërmarrjeve |
| | 3.2 Promovimi i krijimit të vendeve të punës të denjë në industri |
| | 3.3 Integrimi i grave dhe të rinjve në tregun e punës dhe biznes |
| 4. Lehtësimi i industrisë qarkore dhe të gjelbër | 4.1 Mbështetje për ndërmarrjet për të rritur riciklimin dhe qarkullimin në prodhim |
| | 4.2 Mbështetje për ndërmarrjet për të rritur riciklimin dhe qarkullimin në prodhim |
| | 4.3 Mbështetje e përmirësimit teknologjik me fokus në rritjen e efikasitetit të energjisë dhe materialeve |
| 5. Maksimizimi i vlerës së shtuar vendore | 5.1 Rritja e pjesës së inpueteve vendase në prodhim |
| | 5.2 Përmirësimi i inovacionit të produkteve drejt prodhimit me vlerë të shtuar më të lartë |
| | 5.3 Forcimi i lidhjes me ofruesit lokalë të shërbimeve të lidhura me industrinë |



Zbatuar




Pjesërisht të zbatuara



Nuk është zbatuar

Figura 2: Ndryshimi i përqindjes në treguesit që e masin performancën e shtytësve të performancës së parakushteve industriale mes viteve 2022 dhe 2024.



Në përgjithësi, kjo analizë prej tre hapash zbulon një koherencë mjaft të madhe (ose korrelacion) mes avancimeve të bëra në fushat e ndërhyrjes dhe trendeve pozitive drejt arritjes së Objektivave Strategjike që janë cekur më sipër.¹⁰ Me fjalë të tjera, progresi në përforcimin e faktorëve mundësues dhe kapaciteteve industriale që janë priorizuar me SZHIMB 2030 (dhe parashikuar në Objektivat Specifikë) vërtet duket të shoqërohen me

¹⁰ Pjesa tjetër e këtij nënkaptulli paraqet në hollësi performancën e treguesve.

(domethënë, të shpërblehen) me përmirësime në performancën e industrisë (*ndikimi i politikës*).

Më konkretisht, rezultatet tregojnë që ka pasur arritje të qarta në njëmbëdhjetë fusha të ndërhyrjes ndërsa përmirësim të pjesshëm ka pasur në dy objektiva specifike. Për tri fusha të ndërhyrjes, progresi nuk mund të matet për shkak të mungesës së të dhënave. Në pjesën tjetër të këtij nënkapitulli vlerësohen të gjithë objektivat strategjikë dhe paraqitet një interpretim i gjetjeve sa i përket ndryshimeve në parakushtet, faktorët mundësues, shtytësit dhe kapacitetet kryesore industriale që nga viti 2022.

A. ZGJERIMI I PRODHIMIT INDUSTRIAL

Performanca pozitive në këtë objektiv strategjik, të cilën e kemi evidentuar më lart dhe që reflektohet në përmirësimet në të dy TKP-të kryesorë, është **nxitur nga zhvillimet pozitive në fushat e shoqëruara të ndërhyrjes**. Treguesit tonë tregojnë që gjatë dy viteve të fundit, **qasja në financa për prodhuesit në sektorin e prodhimit** është rritur pjesërisht. Më konkretisht, përderisa kreditë vendore nga bankat për firmat private në përgjithësi (të matura me % të BPB-së) janë rritur për 5.5%, pjesëmarrja e këtyre kredive komerciale që janë marrë nga firmat prodhuese është ulur për 7%. Gjatë konsultimeve me palët e interesit janë theksuar këto rezultate përgjithësisht inkurajuese pasi që duket se qasja në burimet vendore të financave mbetet pengesë kyçe ndaj rritjes së prodhimit industrial për NVM-të në Kosovë.

Rritja e prodhimit industrial mund të nxitet përmes burimeve të jashtme të financimit dhe **investimet e huaja** janë me të vërtetë gjithnjë e më të rëndësishme për sektorin e prodhimit në Kosovë. Në përputhje me këtë, analiza tregon një **rritje befasuese në pjesëmarrjen e totalit të investimeve të huaja direkte** që shkojnë në **prodhim**, që është rritur më shumë se dyfish në dy vite (domethënë, një rritje prej 109%). Po ashtu, ka pasur trende inkurajuese drejt investimeve në prodhim dhe akumulimit të kapitalit. Për mallrat kapitale, Kosova mbështetet kryesisht në furnizimin e jashtëm. Të dhënat tregojnë një zgjerim të konsiderueshëm në importimin e këtyre mallrave kapitale (që është **rritur për gati 24%** kur është matur si pjesëmarrje në VSHP). Në konsultimet me palët e interesit është konfirmuar që qasja dhe investimet në mallrat kapitale, të cilat kanë qenë problematike në të kaluarën, **nuk janë më pengesë e madhe** dhe se fondet e huaja kanë luajtur rol në rritjen e investimeve në këtë sektor.

Eksporti është kyç për zgjerimin e prodhimit industrial në Kosovë, në veçanti për t'i shfrytëzuar ekonomitë e shkallës që i ulin kostot marginale dhe mesatare. Megjithatë, produktet duhet të jenë të një cilësie të caktuar, të vërtetuar me certifikata të njohura ndërkombëtarisht, për të pasur mundësi të depërtojnë në tregjet e eksportit. Rezultatet e vlerësimit tregojnë që **çdo herë e më shumë kompani po marrin certifikata përkatëse** dhe numri i produkteve industriale të eksportuara në BE (me një vlerë vjetore të eksportit prej së paku €10,000) është rritur për më shumë se 23% (nga 298 në vitin 2022 në 367 në vitin 2024). Në konsultimet me palët e interesit është theksuar që përderisa qasja në vlerësime të cilësisë dhe konformitetit është bërë më e lehtë për kompanitë e mëdha, më shumë

mbështetje nevojitet për t'ua mundësuar ndërmarrjeve të mesme të vazhdojnë së përmirësuari cilësinë e produkteve dhe marrjen e certifikatave përkatëse.

Për shkak të mungesës së të dhënave, nuk është e mundur të përcaktohet nëse **digjitalizimi** në sektorin e prodhimit është përsheptuar. Megjithatë, në përgjithësi, është shënuar progres ose të paktën progres i pjesshëm në forcimin e atyre parakushteve, faktorëve nxitës dhe aftësive industriale që janë identifikuar në Planin e Veprimit si thelbësore për zgjerimin e prodhimit industrial.

B. REDUKTIMI I DEFICITIT TREGTAR INDUSTRIAL

Rezultatet e vlerësimit tregojnë që mbështetja e ndërmarrjeve për ta shfrytëzuar potencialin e tyre për eksport ka qenë frytdhënëse pasi që **numri i firmave prodhuese që eksportojnë rregullisht** (më shumë se EUR 10,000 në vit) është rritur pothuajse katërfish (nga 733 në vitin 2021 në 2,655 në vitin 2024, duke paraqitur një rritje prej 261%). Kjo është e jashtëzakonshme pasi që nënkupton se caku i vendosur për vitin 2030 prej 2,478 firmash tashmë është arritur shumë më herët¹¹.

Po ashtu, **diversifikimi i tregjeve të eksportit ka shënuar përmirësim të lehtë për 10%**, kur Kosovo eksporton 80% të produkteve të prodhuara në vend në 11 shtete të ndryshme në vitin 2024 krahasuar me vetëm 10 në vitin 2020, që po ashtu ka afekte të tjera sa i përket ekspozimit të reduktuar ndaj tronditjeve të jashtme tregtare. Megjithatë, për ta arritur cakun e vitit 2030 prej 18 vendesh, vendi ka pak vonesa pasi që tashmë është dashur të arrihen 13 vende për t'i përmbushur trendet e pritura për cakun e vitit 2030.

Kjo analizë më e thelluar në nivelin e fushave të ndërhyrjes zbulon se **njëra prej çështjeve më urgjente është zëvendësimi i importit** (i produkteve të ndërmjetme dhe atyre përfundimtare) **me prodhime vendore** pasi që promovimi i produkteve vendore mbetet një sfidë kyçe:

- Edhe pse **pjesëmarrja e mallrave të ndërmjetme të zëvendësueshme në totalin e importeve është rritur** ka shënuar rënje prej më shumë se 13% (nga 52% në vitin 2022 në 44.9% vitin 2024), është ende larg caktit prej 22% për vitin 2030. Për më tepër, trendi po lëviz me një ritëm shumë të ngadalshëm se sa është pritur dhe për ta arritur cakun e vitit 2030, tashmë është dashur të ulej deri në 28.5%.
- **Pjesëmarrja e mallrave të zëvendësueshme për konsum në totalin e importeve tregon një trend të kundërt** pasi që është rritur për 12% (nga 30% në vitin 2022 deri në 33.7% në vitin 2024). Mbetet faktor kyç për tu adresuar pasi që shifrat mbetin larg caktit të vitit 2030 prej 22%.
- Po ashtu, **pjesëmarrja e produkteve vendore në treg është ulur për 10%** (nga 28.8% në vitin 2022 në 25.8% në vitin 2023), që e konfirmon se **zgjerimi i pranisë së mallrave vendore në tregjet e prodhimit mbetet pengesë e qartë**.

¹¹ Shtojca përfshin më shumë shpjegime rreth metodologjisë për analizën në lidhje me targetet dhe shpejtësinë e ndryshimit.

Si përmbledhje, pavarësisht përmirësimit në kapacitetet eksportuese dhe diversifikimit në tregjet e eksportit, deficitin tregtar industrial është përkeqësuar. Kjo mospërputhje ose mungesë koherence në dukje sugjeron se ka edhe faktorë strukturorë në lojë që politika industriale nuk mund t'i kapërcejë e vetme. Në fakt, trendi negativ në bilancin tregtar shoqërohet kryesisht me varësinë e vazhdueshme nga furnizimet e huaja të produkteve të prodhuara, duke përfshirë mallrat e konsumit. Prandaj, zëvendësimi i tyre (të paktën i pjesshëm) me prodhimin vendas vazhdon të mbetet prioritet. Për më tepër, rritja e performancës së eksportit të kompanive vendase nuk e kompenson mungesën e konkurrueshmërisë së kompanive vendase për t'i shërbyer tregut të Kosovës.

C. GJENERIMI I PUNËSIMIT GJITHËPËRFSHIRËS DHE TË DINJITETSHËM

Sektori prodhues i Kosovës ishte mjaft i suksesshëm në krijimin e punësimit gjithëpërfshirës dhe të dinjitetshëm në mesin e viteve 2022 dhe 2024. Në përputhje me këto zhvillime pozitive në tregun e punës në prodhimtari, **të gjitha fushat e ndërhyrjes** nën këtë Objektiv Strategjik kanë **shfaqur trende pozitive**. Në njërin anë, ka pasur avancime në anën e furnizimit të tregut të punës. Më konkretisht, **kualifikimi dhe certifikimi i fuqisë punëtore teknike është përmirësuar** siç është dëshmuar me ngritjen e numrit të institucioneve të akredituara trajnuese në prodhim (për 35%) dhe numrit të standardeve të aprovuara profesionale në prodhim (për pothuajse 42%).

Në anën tjetër, progres kishte edhe në anën e kërkesës pasi që industrinë prodhuese krijuan më shumë vende pune, ndërsa **punësimi zyrtar në sektorin e prodhimit u rrit për 15%. Rritja në vendet e punës përkon me rritjen e mundësive për gratë dhe të rinjtë**. Kjo reflektohet në rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve të punësuar në sektorin e prodhimit në një punësim të përgjithshëm të të rinjve prej 9%. Ngjashëm, pjesëmarrja e sektorit të prodhimit në punësimin e përgjithshëm të grave u rrit për 15%. Gjatë konsultimeve me palët e interesit u dhanë disa faktorë shpjegues për këto trende. Për shembull, u përmend se si mungesa e shkathtësive në prodhim ka krijuar mundësi për njerëzit (duke përfshirë të rinjtë) për t'i arritur benefitet e mundësive të aftësisë dual për qasje në vende pune që paguhen mirë në prodhimtari.

D. LEHTËSIMI I INDUSTRIË QARKORE DHE TË GJELBËR

Trendet inkurajuese në Objektivin Strategjik të promovimit të industrive qarkore dhe të gjelbra janë nxitur nga avancimet në të tri fushat kryesore të ndërhyrjes të targetuara me politikën industriale.

Fillimisht, rezultatet paraqesin **përmirësime të caktuara në reciklimin dhe qarkullimin në prodhim**, pasi që prodhuesit kosovarë e kanë rritur lehtë përdorimin e materialeve të recikluara (për më pak se 0.5%). Përshpejtimi i mëtejshëm i këtij trendi është thelbësor pasi që konsultimet me palët e interesit vunë në dukje sfida të rëndësishme në reciklimin e produkteve dhe valorizimin e mbetjeve. Përveç kësaj, deponitë aktuale pothuajse e kanë arritur kapacitetin e tyre të plotë dhe kjo çështje duhet të adresohet urgjentisht. Disa sektorë kyç, siç është industria e tekstilit, janë duke e konsideruar gradualisht përdorimin

e mallrave të ndërmjetme dhe mbetjeve të recikluara nga industria (p.sh. prerjet), por kjo nishtë është fare në fillim dhe duhet të mbështetet tutje.

Së dyti, përpjekjet e politikës industriale **për promovimin e prodhimit dhe konsumimit të produkteve të gjelbra duket të kenë qenë efektive**. Kjo reflektohet në një rritje prej 7% në pjesëmarrjen e mallrave mjedisore në importin e përgjithshëm, gjë që tregon se firmat po investojnë çdo herë e më shumë në teknologji të pastra (të huaja) ndërkohë që po shfaqin një preokupim në rritje për çështjet mjedisore. Në të ardhmen, një analizë e mallrave të ndryshme të importuara mjedisore do të mundësonte identifikimin e produkteve të mundshme që do të mund të prodhoheshin në vend për ta përmbushur kërkesën vendore. Në fund, rezultatet e vlerësimit sugjerojnë që përpjekjet për **promovimin e përmirësimeve në teknologji** (veçanërisht sa i përket **efiçencës së energjisë dhe materiale**) kanë qenë frytdhënëse, pasi që intensiteti i energjisë në sektorin e prodhimit në Kosovë ka rënë për 13%.

E. MAKSIMIZIMI I RRRITJES SË VLERËS SË BRENDSHME

Më lart, pamë që sektori i prodhimit në Kosovë ka qenë më produktiv që nga lansimi i Planit të Veprimit të SZHIMB-së dhe tani po krijon më shumë vlerë të shtuar për njësi të prodhimit se më herët. Mungesa e të dhënave na pamundëson që ta vlerësojmë rolin e inovacionit në produkte dhe të lidhjeve të përforcuara me ofruesit vendor të shërbimeve të ndërlidhura me industrinë në nxitjen e këtij trendi.

Megjithatë, në fushën e tretë të ndërhyrjes nën këtë Objektiv Strategjik mund të vërejmë progres: **Pjesëmarrja e lëndës së parë vendore në prodhim është rritur** që nga viti 2022. Në anën tjetër, pjesëmarrja e lëndës së parë të ndërmjetme të importuar në VSHP (që është TKP që është përdorur) është ulur për më shumë se 20%. Megjithatë, kufizimet në të dhëna e pamundësojnë zhvillimin e një analize më gjithëpërfshirëse të lidhjeve të mundshme kauzale mes faktorëve mundësues dhe rritjes së përfitimit vendor.

Si përmbledhje, analiza e korrelacioneve apo "koherencës" mes (i) performancës së industrisë (në krahasim me Objektivat Strategjike të SZHIMB-së) dhe (ii) faktorëve të mundshëm shtytës dhe mundësues të politikës (të targetuar në fusha të ndryshme të ndërhyrjes në SZHIMB) e shfaq logjikën e përgjithshme. Po ashtu, e ka theksuar nevojën për ta analizuar më thellë një pengesë kryesore për përmirësimin e deficitit tregtar: progresi i ngadalshëm ose mungesa e progresit në "zëvendësimin e importit të produkteve të ndërmjetme dhe përfundimtare me prodhimin vendor duke i përmirësuar produktet vendore" (Objektivi Specifik 2.3) analiza e thelluar e të cilit mund të ndihmojë në identifikimin e faktorëve kryesor shtytës që qëndrojnë prapa deficitit të vazhdueshëm tregtar industrial të vendit.

4.

VEPRIMET E POLITIKËS: STATUSI I ZBATIMIT DHE KONTRIBUTI NË OBJEKTIVAT E SZHIMB-SË

4.1. STATUSI I ZBATIMIT DHE FAKTORËT SHTYTËS

Ky kapitull ofron një përmbledhje të shkallës në të cilën tashmë janë zbatuar veprimet e politikës të parashikuara me Planin e Veprimit 2023-2025. Më pas, synon të identifikojë disa faktorë kyç që përcaktojnë nëse aktivitetet e planifikuara janë vënë në praktikë apo jo.

TabELA 2 përshkruan statusin e zbatimit të të gjitha veprimeve të politikës në të pesë Objektivat Strategjike. Nga 75 veprimet e parashikuara fillimisht, dy janë hequr që nga lansimi i Planit të Veprimit 2023-2025. Që nga shtatori i vitit 2025, nga 73 veprimet e mbetura, 37 janë zbatuar deri më sot, 15 aktivitete janë zbatuar pjesërisht dhe 21 aktivitete nuk janë zbatuar ende. Me fjalë të tjera, tre muaj para datës së përfundimit të Planit të Veprimit, më shumë se gjysma e veprimeve të planifikuara të politikës raportohet të jenë zbatuar, ndërsa rreth një e treta e tyre ende mbetet të zbatohen.

Veprimet e planifikuara janë shpërndarë në objektivat strategjike si më poshtë:

- 26 aktivitete janë planifikuar për ta adresuar Objektivin Strategjik 1 "Zgjerimi i prodhimit industrial"
- 18 aktivitete janë planifikuar për të kontribuar në Objektivin Strategjik 2 "Reduktimi i deficitit tregtar industrial"
- 12 aktivitete janë planifikuar për ta adresuar Objektivin Strategjik 3 "Gjenerimi i punësimit gjithëpërfshirës dhe të dinjitetshëm".
- 7 aktivitete janë planifikuar për ta promovuar Objektivin Strategjik 4 "Lehtësimi i industrisë qarkore dhe të gjelbër"
- 10 aktivitete janë planifikuar për ta arritur Objektivin Strategjik 5 "Maksimizimi i rritjes së vlerës së shtuar vendore"

TABELA 2: STATUSI I ZBATIMIT TË VEPRIMEVE TË POLITIKËS NË PLANIN E VEPRIMIT 2023 - 2025

| STATUSI I ZBATIMIT | TË GJITHA | OBJ. STRAT. 1 | OBJ. STRAT. 2 | OBJ. STRAT. 3 | OBJ. STRAT. 4 | OBJ. STRAT. 5 |
|-------------------------|------------|----------------------|----------------------|----------------------|---------------------|----------------------|
| Nuk janë zbatuar | 21 (= 29%) | 9 | 6 | 0 | 1 | 5 |
| Janë zbatuar pjesërisht | 15 (= 20%) | 7 | 2 | 3 | 2 | 1 |
| Janë zbatuar | 37 (= 51%) | 10 | 10 | 9 | 4 | 4 |
| Shuma | 73 | 26 (= 36%) | 18 (= 25%) | 12 (= 16%) | 7 (= 10%) | 10 (= 16%) |

Në vijim, synojmë t'i identifikojmë faktorët që potencialisht përcaktojnë nëse (dhe sa në kohë) janë ekzekutuar në të vërtetë veprimet e planifikuara të politikës. Së pari, duam të kuptojmë më mirë nëse ka ndonjë korrelacion mes statusit të zbatimit të një veprimi të politikës dhe (1) nëse është ndarë buxhet për ekzekutimin e tij dhe (2) nëse një pjesë e financimit vjen nga një donator. Sigurisht, ekzistojnë lloje të caktuara të veprimeve të politikës që nuk kërkojnë ndarje të veçantë ose të re të buxhetit pasi zbatimi i tyre parashikohet me burimet ekzistuese (p.sh. hartimi i një ligji nga nëpunësit civilë në një ministri). Në përgjithësi, megjithatë, do të prisnim një korrelacion pozitiv, të mbështetur nga hipoteza se mungesa e ndarjes së buxhetit nënkupton mungesë prioritesh ose, anasjelltas, se ndarja e fondeve pasqyron një qëllim serioz dhe sukses në mobilizimin e burimeve.

TABELA 3: STATUSI I ZBATIMIT TË VEPRIMEVE TË POLITIKËS DHE BURIMI I FINANCIMIT TË TYRE

| STATUSI I ZBATIMIT | BURIMI I FINANCIMIT I PA IDENTIFIKUAR* | BURIMI I FINANCIMIT I IDENTIFIKUAR* | FINANCIMI NGA BUXHETI I KOSOVËS* | (BASHKË-FINANCIM) NGA DONATORËT* |
|--|--|-------------------------------------|----------------------------------|----------------------------------|
| Nuk janë zbatuar | 53% (10) | 24% (11) | 32% (9) | 0% (0) |
| Janë zbatuar ose janë zbatuar pjesërisht | 47% (9) | 76% (35) | 68% (19) | 100% (15) |

*në kohën e hartimit të politikës

Shënim: numrat në kllapa përkojnë me numrin e veprimeve të politikës


Tabela 3 paraqet statusin e zbatimit të veprimeve të politikës duke përshkruar nëse burimi i financimit ishte identifikuar në kohën e hartimit të politikës industriale. Tabela konfirmon që **planifikimi fillestar dhe mobilizimi i burimeve ka rëndësi** pasi që më shumë se gjysma (53%) e aktiviteteve për të cilat nuk ishte identifikuar paraprakisht burimi i financimit nuk janë zbatuar ende. Kjo bie në kundërshtim me faktin se **vetëm një qerek (domethënë, 24%) i aktiviteteve për të cilat ishte identifikuar paraprakisht financuesi i mundshëm nuk janë zbatuar ende.**

Vetëm planifikimi nuk është i mjaftueshëm për të siguruar zbatim dhe **mundësia e burimit financues për të ndarë buxhete me kohë ka rëndësi po ashtu**. Rezultatet tregojnë që **Qeveria e Kosovës mesatarisht ka pasur më shumë vështirësi për t'iu përmbajtur zotimeve buxhetore**: Kur financimi supozohej të vinte ekskluzivisht nga buxheti (i ardhshëm) i Kosovës dhe pa mbështetjen e ndonjë donatori të jashtëm, nivelet e zbatimit (68%) ishin më të ulëta se krahasuar me mesataren për aktivitetet me një burim financimi të identifikuar (76%). Këto rezultate janë në përputhje me supozimin, i cili u shpreh në intervistat me palët e interesit, që **ngërçi aktual politik mund të ketë ndikuar negativisht në shpërndarjen e fondeve publike nga qeveria për zbatimin e aktiviteteve sipas planit**.

Në anën tjetër, pa asnjë përjashtim, **të gjitha aktivitetet që ishte planifikuar të financoheshin nga partnerët donatorë kanë filluar zbatimin** (dhe janë zbatuar plotësisht ose të paktën pjesërisht deri më sot). Pra, duket se shkurtime të buxhetit në agjencitë kryesore si USAID nuk kanë ndikuar shumë në zbatimin e Planit të Veprimit deri më tani. Megjithatë, siç është diskutuar në konsultimet me palët e interesit, ka mundësi që aktivitetet që nuk janë zbatuar ende do të vuajnë nga këto shkurtime buxhetore, për shembull aktivitetet në kuadër të Veprimit 5.2.4 "Mbështetje për institucionet e arsimit të lartë për të krijuar programe inovative ekzekutive në industri". Nevojitet më shumë analizë në një nivel të ndarë për të kuptuar nëse natyra e aktiviteteve të planifikuara në të gjitha llojet e ndryshme të financuesve ndikon në këto rezultate.

Më pas, kemi vlerësuar nëse **rëndësia (e perceptuar) e veprimeve të politikës ka luajtur rol**. Figura 5 sugjeron që kjo duket se është e vërtetë. Siç mund të shihet aty, veprimet politike që ende nuk kanë parë ndonjë zbatim janë gjithashtu ato që, mesatarisht, kanë rezultate më të ulëta të rëndësisë. Në krahasim, rezultatet mesatare të rëndësisë së veprimeve të politikës që janë zbatuar pjesërisht ose plotësisht janë dukshëm më të larta. Megjithatë, është interesante se prioritizimi paraprak i veprimeve të caktuara politike nuk i ka rritur gjatë zbatimit. Mund të pritej që më shumë vëmendje dhe përpjekje do t'i kushtojë nisjes së atyre dhjetë veprimeve të politikës që janë theksuar në kapitullin 7 të dokumentit të SZHIMB-së dhe në preambulën e Planit të Veprimit si thelbësore.¹² Megjithatë, në realitet, modeli i zbatimit të tyre pasqyron në thelb progresin mesatar të zbatimit të pakos së politikave, ku 30% e këtyre veprimeve prioritare nuk janë zbatuar ende.

Figura 3: Vlerësimi i rëndësisë mesatare sipas statusit të zbatimit



¹² Shih fusnotën 6 më lart.

Anketa elektronike që është realizuar si pjesë e vlerësimit dhe që u përmend më lart, është përdorur edhe për të mbledhur më shumë informata që na ndihmon t'i kuptojmë më mirë faktorët nxitës - dhe pengesat - për zbatimin e veprimeve të politikave.

Nga njëra anë, kur zbatimi i veprimeve të planifikuara të politikave nuk kishte filluar ende, të anketuarve iu kërkua të identifikonin pengesat kryesore për ekzekutimin e tyre. Tabela 4 ofron një përmbledhje të njohurive të fituara nga përgjigjet e anketës dhe përshkruan një listë jo të plotë të pengesave kryesore për zbatimin e veprimeve që nuk kanë ndodhur ende. Rezultatet shkojnë përtej kufizimeve financiare dhe pengesat e përmendura nga të anketuarit mund të klasifikohen në gjashtë kategori, përkatësisht:

- Kufizimet buxhetore
- Burimet njerëzore
- Varësitë strukturore ose ligjore
- Sfidat në koordinim
- Koha dhe planifikimi
- Faktorët e tjerë të jashtëm.

TABELA 4: PENGESAT KRYESORE NDAJ ZBATIMIT TË VEPRIMEVE TË PLANIT TË VEPRIMIT (BAZUAR NË PËRGJIGJET NGA ANKETA ME PALËT E INTERESIT)

| LLOJI | SHPJEGIMI | SHEMBULL I VEPRIMIT TË PËRMENDUR |
|--|--|----------------------------------|
| Kufizimet buxhetore | Mungesa e financimit | 5.2.1, 3.1.3 |
| Burimet njerëzore | Mungesa e strukturës ose burimeve njerëzore në agjencitë kryesore | 1.3.1 1.1.1 and 1.1.2 |
| Varësitë strukturore ose ligjore | Aktivitetet nuk kanë mundur të fillojnë sepse varen nga ligje, agjenci ose veprime të tjera paraprake që nuk kanë përfunduar. | 1.1.3, 1.2.7, 1.4.5, 5.1.3 |
| Sfidat në koordinim | Vështirësitë në mobilizimin e universiteteve, fakulteteve dhe akterëve të tjerë Koordinimi i dobët institucional ose pronësia e paqartë | 1.3.4 1.2.8 and 1.3.4 |
| Mangësitë institucionale ose administrative | Mungesa e strukturës apo burimeve njerëzore në agjencitë kryesore dhe Mungesa e iniciativës apo mekanizmave të raportimit | 1.3.1 1.1.1 and 1.1.2 |
| Koha dhe planifikimi | Aktivitetet nuk pritet të fillojnë ende ose janë në fazat e hershme të planifikimit | 4.1.2, 4.2.3 |
| Faktorët e tjerë të jashtëm | Tranzicionet politike ose ndërprerjet globale (p.sh. tregtia) ndikuan në zbatim | 1.2.8, 2.3.3, 4.2.4 2.3.2 |

Siç pritej, disa të anketuar kanë përmendur se mungesa ose vonesa në burimet financiare ishte një pengesë kryesore për zbatimin. Disa aktivitete janë penguar edhe nga burimet e pamjaftueshme njerëzore në agjencitë kryesore për t'i drejtuar programet në mënyrë efektive dhe sipas planit. Megjithatë, problemet dhe ndërlikimet e zbatimit shkojnë përtej mangësive në disponueshmërinë dhe shpërndarjen në kohë të burimeve. Aktivitetet zbatohen brenda pakove dhe ekosistemeve komplekse të politikave me akterë të shumtë.

Në përputhje me këtë, anketa ka theksuar se disa aktivitete nuk mund të fillonin për shkak të varësisë së tyre nga ligje, agjenci ose veprime të tjera paraprake që nuk kanë përfunduar ende. Aktivitetet e tjera u penguan nga legjislati ose korniza të reja ligjore që ende nuk janë në fuqi (p.sh. Ligji për Fondin Sovran ose Ligji për Investime të Qëndrueshme). Fenomene të tilla janë të natyrshme në zbatimin e politikave dhe mund të parandalohen, për shembull, me mekanizma të përmirësuar planifikimi dhe koordinimi.

Çështjet e koordinimit reflektohen në nivele të ndryshme në Kosovë. Për shembull, mobilizimi i burimeve të duhura njerëzore nëpër ekosisteme komplekse duket sfiduese dhe të anketuarit raportuan se disa aktivitete janë penguar nga vështirësia në përfshirjen e palëve përkatëse të interesit, siç janë universitetet, fakultetet dhe akterët e tjerë. Për më tepër, çështje të tjera të qeverisjes, duke përfshirë edhe pronësinë e dobët, mund ta kenë vonuar zbatimin e aktiviteteve të caktuara.

Në disa raste, aktivitetet thjesht nuk ishin planifikuar siç duhet, për shembull nuk kishin bazë dhe nuk ishin parashikuar në planin vjetor të punës të institucionit kryesor ose nuk ishin të planifikuara konkretisht për zbatim në të ardhmen. Në fund, disa aktivitete janë zëvendësuar ose ristrukturuar për shkak të nevojave specifike të sektorit. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, faktorët e jashtëm si tranzicioni politik (p.sh. riorganizimet qeveritare) ose politikat globale ose ndërprerjet e zinxhirit të vlerës kanë shkaktuar vonesa të mëtejshme në zbatimin e aktiviteteve specifike.

Nga ana tjetër, për ato veprime që kanë filluar tashmë (dhe janë ekzekutuar plotësisht ose të paktën pjesërisht), të anketuarve iu kërkua t'i identifikonin edhe faktorët nxitës që kanë ndikuar pozitivisht në zbatim. Në thelb, duke i pasqyruar (ose përmbysur) rezultatet mbi pengesat kryesore të zbatimit, ndarjet e hershme të buxhetit (në kohën e hartimit të Planit të Veprimit) u perceptuan si të domosdoshme për të siguruar zbatim të vërtetë, me norma më të larta zbatimi për aktivitetet e financuara nga donatorët.

Integrimi i veprimit në planin e punës të institucionit kryesor perceptohet si një faktor tjetër kyç suksesi. Për më tepër, koordinimi ndër-institucional (përfshirë atë publiko-privat) dhe përafrimi i objektivave u përmendën si një tjetër shtytës i rëndësishëm i zbatimit. E fundit, nëse rëndësia e një veprimi të politikës shihet dhe pranohet nga akterët përkatës ndihmon shumë: Veprimet që shihen se po i përgjigjen boshllëqeve të qarta (në shkathtësi, certifikime, etj.) - domethënë, boshllëqe për të cilat ka pasur një konsensus dhe ku është identifikuar një nevojë e qartë për veprim nga palët kryesore të interesit - kanë më shumë gjasa të vihen në praktikë.


4.2. AKTIVITETET DHE KONTRIBUTI NË OBJEKTIVAT E POLITIKËS INDUSTRIALE

Ky nënkapitull synon të hedhë dritë mbi mënyrën se si zbatimi i Planit të Veprimit mund të ketë kontribuar në performancën e fundit të industrisë së Kosovës, të cilën e kemi shqyrtuar më sipër. Për ta bërë këtë, së pari analizojmë korrelacionin mes statusit të zbatimit të veprimeve të politikës në njëra anë dhe performancës së objektivave strategjike në të cilët ato pritet të kontribuojnë (sipas logjikës së ndërhyrjes së Politikës Industriale) në anën tjetër. A mund të vërehet më shumë progres në një objektiv të caktuar strategjik nëse pakoja përkatëse e veprimeve të politikës karakterizohet me një shkallë më të lartë zbatimi?

Figura 4 përpiqet ta adresojë këtë pyetje dhe për çdo objektiv strategjik tregon shkallën e zbatimit të veprimeve në Planin e Veprimit (në përqindje relative). Objektivat strategjike mund të klasifikohen në tri grupe, si në vijim:


- **Objektivat Strategjikë 3 dhe 4 janë ata me nivelin më të lartë të zbatimit** me respektivisht 100% dhe 86% të aktiviteteve të zbatuara ose të zbatuara pjesërisht, që është në përputhje me performancën e mirë të këtyre objektivave strategjike.
- **Për Objektivat Strategjikë 1 dhe 2, nuk paraqiten modele domethënëse.** Në të dyja rastet, rreth një e treta e aktiviteteve nuk janë zbatuar ende, por megjithëse ka pasur përmirësime në Objektivin Strategjik 1, TKP-të për Objektivin Strategjik 2 tregojnë një trend negativ.
- **Objektiivi 5 është ai që ballafaqohet me nivelin më të ulët të zbatimit** të veprimeve të tij, pasi që 50% e tyre nuk janë zbatuar ende. Megjithatë, objektiivi strategjik tregon performancë të mirë. Nevojiten më shumë analiza të thelluara për ta kuptuar më mirë rëndësinë dhe natyrën e aktiviteteve që tashmë janë zbatuar dhe atyre që mungojnë.

Figura 4: Statusi i zbatimit të veprimeve të politikës në të gjithë objektivat strategjike (në %)



Analizimi vetëm i nivelit të zbatimit nuk është i mjaftueshëm për të kuptuar se si veprimet mund të kenë kontribuar në rezultate. Figura 5 paraqet si madhësinë (në aspektin e numrit të veprimeve të politikës të parashikuara në Planin e Veprimit) ashtu edhe rëndësinë (e perceptuar) (në aspektin e pikëve mesatare të rëndësisë) të paketove të politikave në të pesë objektivat strategjike të politikës industriale. Siç mund të shihet aty, një numër i lartë veprimesh nuk garanton sukses (= progres në objektivat): Objektivi Strategjik 2 mbështetet nga numri i dytë më i lartë i aktiviteteve, por është ende e vetmja zonë me ndikim me një trend negativ (me një rritje të vazhdueshme të deficitit tregtar industrial).

Figura 5: Madhësia dhe rëndësia e pakove të politikave në të gjithë objektivat strategjikë



Nga Figura 5 është e rëndësishme të vërehet edhe se **dy Objektivat Strategjikë me shkallën më të lartë të zbatimit të aktiviteteve** (gjegjësisht objektivat #3 dhe #4) janë po ashtu në mesin e objektivave me numrin më të ulët të veprimeve të parashikuara të politikës (shih

TabELA 2). Një mësim për t'u marrë parasysh është se mund të jetë më mirë të kemi një pako koncize dhe të fokusuar të instrumenteve të politikës që zbatohen në të vërtetë, sesa të parashikohen një sërë masash që nuk është e mundur të zbatohen plotësisht (p.sh. për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme të zbatimit, vështirësive që lindin në koordinim ose kompromiseve buxhetore). Me fjalë të tjera, **kombinimi i politikave i përcaktuar mirë, i kalibruar mirë dhe i targetuar duket të jetë një qasje më efektive dhe më efikase për t'i çuar përpara objektivat strategjikë.**

Analiza e rëndësisë së pakove të politikës ofron dy mësimë interesante¹³. Fillimisht, **sfida më urgjente është reduktimi i deficitit tregtar industrial.** Edhe pse janë planifikuar burimet e rëndësishme për përmirësimin e deficitit tregtar në prodhimtari, ku 25% e veprimeve të Planit të Veprimit (pra, 18 aktivitete) janë ndarë për këtë objektiv, **pakoja e politikës për këtë fushë shihet si grupi i veprimeve relativisht më së paku i rëndësishëm në të gjithë pesë objektivat strategjikë.**

Së dytë, Objektiv 3 e ka njërin prej **numrave më të ulët të veprimeve të planifikuara përkundër performancës së lartë** të shfaqur. Megjithatë, analiza e rëndësisë së veprimeve tregon që trendi pozitiv ndërlidhet me faktin se **pakoja e politikës së këtij objektiv perceptohet si më e rëndësishmja.** Kjo sugjeron që disa veprime të targetuara që janë drejtpërdrejt relevante mund të jenë më efikase se sa pakot shumë ambicioze që janë të vështira për tu zbatuar.

Për të kuptuar më mirë sa kanë kontribuar aktivitetet në rezultate, nevojitet një analizë në një nivel më të ulët të klasifikimit, domethënë në nivelin e fushave të ndërhyrjes. TabELA 5 paraqet statusin e zbatimit të veprimeve në të gjitha fushat e ndërhyrjes. Kjo na mundëson t'i klasifikojmë objektivat specifike në katër lloje, si më poshtë:

- **Koherente.** Aktivitetet kryesisht janë zbatuar dhe fushat përkatëse të ndërhyrjes tregojnë performancë të mirë, ose shumica e aktiviteteve nuk janë zbatuar ende dhe objektivat specifike përkatëse tregojnë performancë të dobët.
- **Jo koherent:** Aktivitetet kryesisht janë zbatuar dhe parakushtet, mundësuesit ose kapacitetet shoqëruese industriale shfaqin performancë të dobët, ose shumica e aktiviteteve nuk janë zbatuar ende dhe objektivat përkatës specifike shfaqin performancë të mirë.
- **E paqartë.** Nuk mund të përcaktohen modele konkrete të koherencës ose mungesës së koherencës.
- **E PA ZBATUESHME** Mungesa e të dhënave na ka pamundësuar që ta përcaktojmë performancën në fushën e caktuar të ndërhyrjes.

TABELA 5: VLERËSIMI I KOHERENCËS NDËRMJET PERFORMANCËS NË FUSHAT E ZBATIMIT DHE STATUSIT TË ZBATIMIT TË VEPRIMEVE TË PLANIFIKUARA TË POLITIKËS INDUSTRIALE

| NUMRI I OBJEKTIVIT SPECIFIK | FUSHA E NDËRHYRJES EMRI I OBJEKTIVIT SPECIFIK | NR. I AKTIVITETEVE TË ZBATUARA | NR. I AKTIVITETEVE TË ZBATUARA PJESËRISHT | NR. I AKTIVITETEVE TË PA ZBATUARA | VLERËSIMI I KOHERENCËS |
|-----------------------------|--|--------------------------------|---|-----------------------------------|------------------------|
| 1.1 | Lehtësimi i qasjes në financa për prodhuesit vendorë | 0 | 0 | 3 | Jo koherent |

¹³ Shih kapitullin e metodologjisë për më shumë informata rreth llogaritjes së rezultatit të rëndësisë së veprimeve.

| | | | | | |
|-----|---|---|---|---|-------------------------------|
| 1.2 | Rritja e investimeve në prodhim | 5 | 2 | 0 | Koherent |
| 1.3 | Përsheptimi i digjitalizimit në prodhim | 1 | 1 | 2 | E pa zbatueshme ¹⁴ |
| 1.4 | Rritja e cilësisë dhe certifikimit të produkteve të njohura ndërkombëtarisht | 4 | 4 | 1 | Koherent |
| 2.1 | Mbështetja e ndërmarrjeve për ta shfrytëzuar potencialin e tyre të eksportit | 7 | 1 | 1 | Koherent |
| 2.2 | Diversifikimi i tregjeve të eksportit | 2 | 0 | 1 | Koherent |
| 2.3 | Zëvendësimi i importit të produkteve të ndërmjetme dhe përfundimtare me prodhime vendore dhe promovimi i produkteve vendore | 1 | 1 | 4 | E paqartë |
| 3.1 | Ngritja e kualifikimit dhe certifikimit të fuqisë punëtore teknike dhe menaxherëve të kompanive | 4 | 3 | 0 | Koherent |
| 3.2 | Promovimi i krijimit të vendeve të denja të punës në industri | 2 | 0 | 0 | Koherent |
| 3.3 | Integrimi i grave dhe të rinjve në tregun e punës | 3 | 0 | 0 | Koherent |
| 4.1 | Mbështetja për ndërmarrjet për ta rritur riciklimin dhe qarkullimin në prodhim | 2 | 1 | 0 | Koherent |
| 4.2 | Mbështetja për ndërmarrjet për ta rritur riciklimin dhe qarkullimin në prodhim | 1 | 1 | 1 | E pa zbatueshme |
| 4.3 | Mbështetja e përmirësimit teknologjik me fokus në rritjen e efikasitetit të energjisë dhe materialeve | 1 | 0 | 0 | Koherent |
| 5.1 | Rritja e përqindjes së inputeve vendore në prodhim | 1 | 1 | 1 | E paqartë |
| 5.2 | Përmirësimi i inovacionit të produkteve drejt prodhimit me vlerë më të lartë të shtuar | 1 | 0 | 3 | E pa zbatueshme |
| 5.3 | Forcimi i lidhjeve me ofruesit e shërbimeve vendase të lidhura me industrinë | 2 | 0 | 1 | E pa zbatueshme |

Në shumicën e rasteve, statusi i zbatimit të veprimeve përkatëse të politikës është koherent me performancën e fushave të shoqëruara të ndërhyrjes. Kjo është e vërtetë për Objektivat Specifikë 1.2, 1.4, 2.1, 2.2, 3.1, 3.2, 3.3, 4.1, dhe 4.3. Në të gjitha këto raste, shumica e veprimeve të planifikuara të politikës është zbatuar të paktën pjesërisht që, pastaj, reflektohet edhe në progres pozitiv drejt arritjes së këtyre Objektiveve Specifikë. Kjo mund të merret si shenjë që **këto instrumente të politikës** (apo të paktën kombinimi i masave të politikës) **kanë qenë efektive** për t'i nxitur ndryshimet dhe zhvillimet e dëshiruara.

¹⁴ "E pa zbatueshme" përkon me fushat e ndërhyrjes për të cilat nuk ka pasur të dhëna të disponueshme për llogaritjen e TKP-ve, prandaj nuk kemi pasur mundësi t'i ndërlidhim rezultatet e fushave të ndërhyrjes me statusin e zbatimit të aktiviteteve.

Le t'i diskutojmë tani shkurtimisht rastet tjera. **Për fushën e ndërhyrjes 1.1**, rezultatet duken jo koherente pasi që përmirësimi i pjesshëm në "qasjen në financa për prodhuesit vendorë" është arritur pa u zbatuar ende tri veprimet e mëposhtme të planifikuara:

- Realizimi i studimit të fizibilitetit për themelimin e Bankës së Kosovës për Zhvillim
- Plotësimi i kornizës rregullative për tregun e letrave me vlerë të korporatave dhe instrumente të tjera të ngjashme financiare
- Themelimi i Zyrës Këshillimore për Qasje në Financa.

Përderisa asnjëra prej tyre nuk është zbatuar ende, fusha e ndërhyrjes ende shfaq përmirësim të pjesshëm. Dy tregues janë përdorur për ta analizuar performancën në këtë objektiv specifik: volumi i *kreditit vendor për sektorin privat nga bankat* (e matur si % e BPB-së), që është përmirësuar: dhe *përqindja e prodhimit në kreditë e përgjithshme komerciale*, që është përkeqësuar lehtësisht. Së bashku, duket se përderisa bankat komerciale e kanë zgjeruar huadhënien e tyre, një pjesë e madhe e këtyre kredive të reja ka shkuar në sektorë të tjerë jashtë prodhimit. Me fjalë të tjera, **sektori i prodhimit duket se nuk ka qenë në gjendje ta shfrytëzojë plotësisht disponueshmërinë e shtuar të financave**. Megjithatë, qasja e përgjithshme në financa për prodhuesit vendorë është përmirësuar edhe pse veprimet përkatëse të politikës industriale nuk janë zbatuar ende.

Fusha e ndërhyrjes 2.3 ("Zëvendësimi i importit të produkteve të ndërmjetme dhe përfundimtare me prodhim vendor dhe promovimi i produkteve vendore") shfaq përmirësim të pjesshëm. Origjina e këtij rezultati të përzier është e vështirë të interpretohet pasi që, në njërin anë, vetëm një TKP shfaq përmirësim dhe dy shfaqin trende negative dhe, në anën tjetër, vetëm një nga gjashtë veprimet e përcaktuara në Planin e Veprimit për këtë fushë të ndërhyrjes është zbatuar (ndërsa një është zbatuar pjesërisht dhe katër nuk janë zbatuar ende).

Tabela 6 e përmbledh statusin e zbatimit të veprimeve në kuadër të fushës së ndërhyrjes 2.3.

TABELA 6: STATUSI I ZBATIMIT TË VEPRIMEVE NË KUADËR TË FUSHËS SË NDËRHYRJES 2.3 "ZËVENDËSIMI I IMPORTEVE TË PRODUKTEVE TË NDËRMJETME DHE PËRFUNDIMTARE ME PRODHIME VENDORE DHE PROMOVIMI I PRODUKTEVE VENDORE"

| NUMRI I VEPRIMIT | PËRSHKRIMI I VEPRIMIT | STATUSI I ZBATIMIT |
|------------------|--|------------------------|
| 2.3.1 | Përgatitja e një analize për identifikimin e produkteve përfundimtare me potencial për t'u zëvendësuar | I zbatuar |
| 2.3.2 | Përmirësimi i regjimit të tarifave të importit për të ofruar mbrojtje për produktet strategjike | Nuk është zbatuar ende |
| 2.3.3 | Përfshirja e një marzhi preferencial kalimtar në prokurimin publik për produktet vendore (shënim: nuk vlen për produktet me origjinë nga BE, CEFTA, SHBA dhe EFTA) | Nuk është zbatuar ende |
| 2.3.4 | Ofrimi i granteve për të rinjtë, përmes qendrave të inovacionit, për të zhvilluar projekte kreative promovuese për konsumimin e produkteve vendore. | Nuk është zbatuar ende |
| 2.3.5 | Hapja e një fushate informuese për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për blerjen e produkteve vendore | Nuk është zbatuar ende |
| 2.3.6 | Hartimi i politikës tregtare (programi i tregtisë) | I zbatuar pjesërisht |

Për t'i kuptuar më mirë rezultatet e përziera në këtë fushë të ndërhyrjes, shqyrtimi i ndikimit të mundshëm të veprimeve në tre treguesit e fushës së ndërhyrjes mund të jetë informues, qoftë për t'i kuptuar (i) trendet aktuale ose (ii) çfarë mund t'i zbusë në të ardhmen këto trende negative, me kusht që të zbatohet pakjoja e plotë e politikës.

Në anën pozitive, siç u tha, ka pasur përmirësim në TKP-në që e mat **pjesëmarrjen e mallrave të ndërmjetme të zëvendësueshme në importin e përgjithshëm që është ulur**. Në kohën e vlerësimit, Politika Tregtare ishte hartuar vetëm pjesërisht (Veprimi 2.3.6) dhe veprimet e ardhshme në kuadër të Politikës Tregtare mund të shkaktojnë ndryshime të mëtejshme pozitive. Veprimet aktuale që nuk janë nën këtë fushë të ndërhyrjes mund të kenë shkaktuar ndryshime pozitive në këtë tregues. Pengesa kryesore e identifikuar përmes diskutimeve me palët e interesit është qasja në certifikim, pasi që kompanitë kanë tendencë të importojnë mallra të ndërmjetme të certifikuar për t'i riekportuar më pas mallrat përfundimtare. Prandaj, krijimi i Qendrës Kombëtare të Certifikimit mund të ketë luajtur një rol pozitiv.

Në anën negative, **pjesëmarrja e mallrave të zëvendësueshme për konsum në importin e përgjithshëm është rritur**. Pra, edhe pse analiza për "identifikimin e produkteve të importuara përfundimtare me potencial për zëvendësim" është kryer (Veprimi 2.3.1), duhet bërë më shumë për të nxitur ndryshime pozitive, pasi që disa parakushte të pafavorshme mund t'i pengojnë kompanitë lokale të konkurrojnë në tregjet lokale. Veprimet e tjera që janë planifikuar, por që ende nuk janë zbatuar, mund të jenë drejtpërdrejt të dobishme dhe të shkaktojnë ndryshime pozitive, siç është përmirësimi i regjimit të tarifave të importit për të siguruar mbrojtje për produktet strategjike (e parashikuar në Veprimin 2.3.2), përfshirja e një marzhi preferencial kalimtar në prokurimin publik për produktet vendore (Veprimi 2.3.3), ose promovimi dhe rritja e ndërgjegjësimit për blerjen e produkteve lokale (Veprimet 2.3.4 dhe 2.3.5). megjithatë është e vështirë të parashikohet ndikimi i mundshëm i këtyre veprimeve pasi që Kosova është anëtare e dhjetëra marrëveshjeve tregtare¹⁵ të cilat

¹⁵ Kosova është anëtare e CEFTA-s, SAA-së (BE), Turqi dhe EFTA (pritet të ratifikohet nga Kuvendi).

vendosin disiplina dhe kufizime të fuqishme ndaj diskriminimit të mallrave të importuara, duke e ndaluar vendosjen e tarifave shtesë ose futjen e subvencioneve të përzgjedhura në favor të produkteve vendore (shkelja e kushteve tregtare).

Në fund, siç u shpjegua më lart, **pjesëmarrja e produkteve të prodhuara në vend në tregjet vendore ka rënë edhe më shumë**, që konfirmon se zgjerimi i pranisë së mallrave vendore në tregjet e prodhimit mbetet një sfidë e qartë. Dhjetëra veprime që janë planifikuar nën këtë fushë të ndërhyrjes por të cilat nuk kanë filluar ende në fakt mund të kenë ndikim pozitiv në pjesëmarrjen e produkteve të prodhuara në vend në pjesëmarrjen në treg (duke përfshirë Veprimet 2.3.2, 2.3.3, 2.3.4 apo 2.3.5). Megjithatë, ka gjasa që fizibiliteti dhe efektiviteti i tyre të përballen me të njëjtët faktorë të jashtëm kufizues siç janë kufizimet në hapësirën e politikave të vendosura me marrëveshjet tregtare.

5.

ANALIZA TË THELLUARA TË LOGJIKËS SË NDËRHJRJES DHE AKTIVITETEVE TË PËRZGJEDHURA

Kjo pjesë ofron një analizë të thelluar të tri veprimeve të politikës me interes të veçantë dhe se si ato kanë kontribuar në progresin drejt objektivave specifike dhe strategjike. Këto instrumente të politikës ishin gjithashtu fokus i intervistave gjysmë të strukturuar që u realizuan në fillim të shtatorit 2025. Qëllimi i kësaj analize të thelluar është të krijojë një kuptim më të mirë të logjikave të ndërhyrjes dhe mekanizmave të zbatimit pas masave specifike të politikës, me shpresën për të identifikuar faktorë të përbashkët që përcaktojnë efektivitetin e tyre. Veprimet e politikës të përzgjedhura janë:

- Krijimi i Qendrës Kombëtare për Certifikimin e Produkteve
- Zgjerimi i dritares së eksportit nën Fondin Kosovar për Garanci Kreditore
- Krijimi i një programi të punësimit në sektorin e prodhimit në kuadër të kornizës së Masave Aktive të Tregut të Punës

5.1. KRIJIMI I QENDRËS KOMBËTARE PËR CERTIFIKIMIN E PRODUKTEVE

Prodhimi industrial në Kosovë është zgjeruar nga viti 2022 deri në 2024, duke treguar progres drejt Objektivit Strategjik 1 në Politikën Industriale. Për të nxitur dhe mbështetur këtë zgjerim industrial, Plani i Veprimit 2023-2025 përcaktoi katër fusha me prioritet të ndërhyrjes, duke përfshirë edhe "përmirësimin e cilësisë dhe certifikimit të produkteve të njohura ndërkombëtarisht". TKP i përdorur për të përcjellë arritjet në këtë fushë tregon progres: Numri i produkteve industriale që Kosova ka mundur t'i eksportojë në BE është rritur dukshëm që nga viti 2022, kur u lansua Plani i Veprimit.

Për të përmirësuar cilësinë dhe certifikimin e produkteve të njohura ndërkombëtarisht, Plani i Veprimit 2023-2025 përcaktoi nëntë aktivitete. Deri më tani, katër prej tyre janë zbatuar (duke përfshirë edhe krijimin e Qendrës për Certifikimin e Produkteve) dhe mund të kenë kontribuar në arritjen e rezultateve të dëshiruara (p.sh. rritja e numrit të produkteve

industriale të eksportuara). Nga pesë veprimet e mbetura të politikës, katër janë zbatuar pjesërisht dhe një ende nuk është zbatuar. Tabela 7 tregon statusin e zbatimit të të gjitha aktivitetëve në këtë fushë të ndërhyrjes.

TABELA 7: STATUSI I ZBATIMIT TË VEPRIMEVE NËN OBJEKTIVIN SPECIFIK 1.4 "PËRMIRËSIMI I CILËSISË DHE CERTIFIKIMIT TË PRODUKTEVE TË NJOHURA NDËRKOMBËTARISHT"

| AKTIVITETET E ZBATUARA | AKTIVITETET E ZBATUARA PJESËRISHT | AKTIVITETET QË NUK JANË ZBATUAR ENDE |
|--|---|--|
| 1.4.1 Krijimi i Qendrës Kombëtare për Certifikimin e Produkteve | 1.4.2 Ofrimi i mbështetjes financiare për trupat për vlerësim të konformitetit (TVK) për të përmirësuar pajisjet e tyre dhe për të ndërtuar kapacitete operationale | 1.4.5 Hartimi i akteve nënligjore që rrjedhin nga ligji për sigurinë e përgjithshme të produkteve |
| 1.4.7 Organizimi i punëtorive për zbatimin e legjislacionit teknik për infrastrukturën e cilësisë dhe standardet mbështetëse | 1.4.3 Hartimi i një plani të veprimit që përcakton hapat që Drejtoria e Akreditimit të Kosovës (DAK) duhet të ndërmarrë për të përmbushur kërkesat për anëtarësim të plotë në Organizatat Evropiane të Akreditimit (EA). | |
| 1.4.8 Takime informuese me bizneset mbi krijimin e organeve certifikuese për grupe të caktuara të produkteve joushqimore | 1.4.4 Hartimi i ligjit për mbikëqyrjen e përputhshmërisë së produkteve në treg | |
| 1.4.9 Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese për promovimin e dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit lidhur me garancitë e produkteve | 1.4.6 Hartimi i akteve nënligjore që rrjedhin nga ligji për sigurinë e përgjithshme të produkteve | |

Në Kosovë, kostot e certifikimit mbeten një pengesë e madhe për zgjerimin e prodhimit industrial. Përputhja me standardet e vendosura dhe qasja në certifikimin përkatës janë thelbësore për të mundësuar që kompanitë vendore të përmirësojnë cilësinë e produkteve të tyre, të optimizojnë proceset dhe sistemet e prodhimit (duke i bërë më efikase dhe duke rritur kështu produktivitetin), të fitojnë besimin e klientëve dhe konsumatorëve (si vendor, ashtu edhe të huaj) dhe të eksportojnë në tregje të rëndësishme si BE-ja dhe SHBA-ja. Në parim, ofrimi i produkteve të certifikuara duhet të ndihmojë kompanitë lokale të përforcojnë pjesëmarrjen në tregjet vendore (duke zëvendësuar importet) dhe në tregjet e huaja, dhe për pasojë të rrisin prodhimin total. Janë të nevojshme dy lloje certifikimesh për të ulur deficitin tregtar: certifikime për të rritur eksportet e produkteve përfundimtare dhe certifikime të mallrave ndërmjetëse për të zvogëluar varësinë nga produktet e huaja.

Një nga pengesat kryesore është mungesa e trupave certifikues lokalë, gjë që e bën certifikimin të shtrenjtë dhe të paarrtshëm për shumë biznese. Gjithashtu, nuk ka laboratorë lokalë për testimin e produkteve, gjë që krijon varësi nga institucionet e jashtme dhe vonon kohën e certifikimit. Si pasojë, certifikimi duhet të bëhet jashtë vendit, dhe shumë pak kompani mund të përballojnë kostot. Nga ana pozitive, ka mjaft konsulentë të

kualifikuar vendor në Kosovë që mund të ndihmojnë bizneset për t'u përgatitur për certifikim.

Shumë kompani lokale mbështeten shumë tek importi i produkteve të certifikuara nga jashtë. Për këtë arsye, interesi për certifikime të produkteve përfundimtare shihet si më i domosdoshëm sesa për mallrat ndërmjetëse. Disa sektorë, si ai i mobileve nga druri, do të përfitonin nga qasja në dru të burimeve vendore. Kjo gjithashtu mund të rrisë dhjetëfish vlerën e drurit vendor, i cili aktualisht përdoret kryesisht për zjarr. Megjithatë, menaxhimi i pyjeve dhe përgatitja e tyre për certifikim mund të zgjasë vite¹⁶. Sektorët tjerë, si sektori i frutave dhe perimeve të freskëta, përballen me problemin e fuqisë së ulët të negocimit me distributorët vendorë, gjë që e bën tregun lokal jo të favorshëm. Prandaj, ata mbështeten ekskluzivisht te eksporte. Qasja në certifikim bëhet akoma më e rëndësishme për ta.

Për të adresuar këtë çështje, Qendra për Certifikimin e Produkteve është një skemë grantesh që ndihmon kompanitë prodhuese me potencial eksporti dhe zëvendësimi të importeve për të fituar certifikim të njohur ndërkombëtarisht. Qeveria mbulon 60% të kostos me një shumë maksimale deri në 15,000 EUR. Kompanitë përfitues duhet të kontribuojnë 40% të shpenzimeve. Duke qenë se kostot e certifikimit për produktet metalike zakonisht janë më të larta, shuma maksimale e parashikuar për këtë kategori është deri në 50,000 EUR. Formula e ndarjes së kostove është e njëjtë, pra 60%-40%. Kostot e pranueshme për certifikimin e produkteve përfshijnë testimin, verifikimin, certifikimin dhe inspektimin. Granti është i hapur çdo vit, dhe kompanitë përfitues kanë 12 muaj për zbatimin.

Sektorët kryesorë në Kosovë që përfitojnë nga qasja e përmirësuar në certifikim janë industria e drurit, plastikës, ndërtimit, metalit dhe tekstilit. Skema ka mbështetur 9 kompani prodhuese në vitin 2023, 23 të tjera në 2024 dhe 27 kompani prodhuese në gjysmën e parë të vitit 2025 për të certifikuar produktet e tyre. Kjo u ka mundësuar atyre të hyjnë në tregje të reja të eksportit dhe të zgjerojnë prodhimin gjatë rrugës.

Skema ka dëshmuar se është një instrument i rëndësishëm për të shfrytëzuar potencialin e eksportit të kompanive në Kosovë – gjë që bëhet e dukshme edhe te TKP për këtë Objektiv Specifik. Megjithatë, informatorët kryesorë të intervistuar për këtë vlerësim theksuan se skema mbështet kryesisht kompanitë që janë tashmë të përgatitura për të arritur certifikimin. Në fakt, në vitet 2023 dhe 2024, instrumenti nuk arriti objektivin e përkufizuar për 30 kompani përfituese në vit. Raportohet se, megjithëse buxheti dhe planifikimi parashikonin mbështetjen e deri në 30 bizneseve, nuk kishte mjaft aplikime të suksesshme. Në këtë drejtim, ka nevojë për veprime plotësuese në fazat fillestare të procesit për të ndihmuar kompanitë në rritje të parashikojnë nevojat për certifikim.

Për më tepër, me zbatimin e ardhshëm të Mekanizmit të Rregullimit të Kufirit të Karbonit të BE-së (CBAM), i cili është instrumenti kryesor për adresimin e emetimeve të karbonit të

¹⁶ Sipas palëve të interesit të intervistuar, shumica e drurit vendor përdoret për ngrohje me vlerë të ulët, ndërsa druri i përpunuar mund të sjellë dhjetë herë më shumë të ardhura. Druri për përpunim importohet kryesisht nga Austria dhe tashmë është i certifikuar. Menaxhimi i përmirësuar i pyjeve është kyç për kalimin tek produktet me vlerë më të lartë. Edhe pse Kosova eksporton 80 milionë euro në vit drurë dhe produkte druri, pak prej tyre kërkojnë certifikim, siç janë dyert. Kapaciteti prodhues i vendit është i përdorur pjesërisht, me vetëm 60% të makinerive në funksion. Në vend që të investohet në më shumë pajisje, fokusi duhet të jetë tek dizajni inovativ dhe diferencimi i produkteve. Po bëhen përpjekje për gjeolokacionin e burimeve të drurit, që mund të përmirësojë gjurmueshmërinë dhe të mbështesë certifikimin e ardhshëm.

përfshira në mallrat e eksportuara në BE, kompanitë eksportuese në Kosovë do të duhet të përmbushin këto kërkesa për të shmangur tarifën doganore. Prandaj, është thelbësore të zgjerohet skema për të mbështetur kompanitë në sektorët e prekur (p.sh. përpunimi i metalit) për të përmbushur këto kërkesa të reja.

5.2. ZGJERIMI I DRITARES SË EKSPORTIT NËN FONDIN KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE

Për të arritur Objektivin Strategjik 2 të Politikës Industriale, që është të ulë deficitin tregtar – i cili, siç u pa më lart, mbetet një çështje e rëndësishme – Plani i Veprimit është fokusuar në tri fusha kryesore të ndërhyrjes. Një nga to është të ofrohet mbështetje për prodhuesit për të shfrytëzuar potencialin e tyre të eksportit.

Edhe pse deficieti tregtar është përkeqësuar mes viteve 2022 dhe 2024 për shkak të rritjes së importeve, ky trend zbutet disi nga numri gjithnjë në rritje i kompanive prodhuese që eksportojnë rregullisht.¹⁷ Për të mbështetur ndërmarrjet në shfrytëzimin e potencialit të tyre të eksportit, brenda Planit të Veprimit 2023-2025 të Politikës Industriale u përcaktuan nëntë aktivitete. Tabela 8 tregon statusin e zbatimit të tyre tregohet në tabelën përkatëse. Shtatë aktivitete janë zbatuar plotësisht, duke përfshirë zgjerimin e dritares së eksportit në kuadër të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), një aktivitet është zbatuar pjesërisht, dhe një tjetër ende nuk është zbatuar.

TABELA 8: STATUSI I ZBATIMIT TË VEPRIMEVE TË POLITIKËS SIPAS OBJEKTIVIT SPECIFIK 2.1 “MBËSHTETJA E NDËRMARRJEVE PËR TË SHFRYTËZUAR POTENCIALIN E TYRE TË EKSPORTIT”

| AKTIVITETET E ZBATUARA | AKTIVITETET E ZBATUARA PJESËRISHT | AKTIVITETET QË NUK JANË ZBATUAR ENDE |
|--|---|---|
| 2.1.1 Zgjerimi i dritares së eksportit në kuadër të FKGK | 2.1.2 Krijimi i Qendrës për Informacion mbi Tregun e Eksportit (QITE). | 2.1.9 Angazhimi i anëtarëve të diasporës për të ndihmuar eksportet në industri në kuadër të Programit për Diplomaci Qytetare |
| 2.1.3 Organizimi i misioneve të shitjeve në tregjet e huaja për kompani të gatshme për eksport në sektorë specifike | | |
| 2.1.4 Identifikimi i klientëve potencialë në tregjet e huaja dhe organizimi i vizitave brenda vendit | | |
| 2.1.5 Organizimi i takimeve rajonale B2B midis furnizuesve lokalë dhe rajonalë për krijimin e rrjeteve të bashkëpunimit | | |
| 2.1.6 Zhvillimi i analizës për të vlerësuar ndikimin e aktiviteteve për promovimin e eksportit | | |
| 2.1.7 Krijimi i programi për mentorim për të lidhur anëtarët e diasporës së Kosovës me përvojë në prodhim me eksportuesit potencial | | |
| 2.1.8 Kompletimi i katalogut (regjistrit) të eksportuesve të Kosovës | | |

Në parim, Kosova përfiton nga afërsia e saj dhe nga statusi potencial kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, gjë që lehtëson qasjen tek klientët dhe prodhuesit

¹⁷ Siç u pa më lart, TKP për këtë Objektiv Specifik tregoi një përmirësim aq dinamik sa që, në fakt, vlera e synuar e vendosur për vitin 2030 është arritur tashmë.

evropianë të mallrave ndërmjetëse përmes kushteve të favorshme (p.sh. pa dogana dhe TVSH për makineritë e përpunimit dhe pa tarifa eksporti për ri-eksporte). Për shkak të madhësisë së kufizuar të tregut lokal me 1.6 milion banorë¹⁸, eksporti mbetet thelbësor për kompanitë vendore në Kosovë për t'u rritur dhe për të shfrytëzuar ekonomitë e shkallës. Ulja e kostove mesatare për njësi përmes përdorimit të ekonomive të shkallës mund t'i bëjë ato më konkurruese në tregjet vendore dhe të reduktojë varësinë e vendit nga importet, që është një problem i madh në Kosovë.

Kompanitë vendore shpesh bien në kurth kur gjejnë mundësi për eksport, për shembull përmes panairëve tregtare, pasi kanë nevojë për mbështetje të konsiderueshme financiare për të zgjeruar prodhimin shpejt, por nuk disponojnë kolateral për të marrë kredi nga bankat komerciale. Dritarja e Eksporteve e FKGK-së mbështet kompanitë prodhuese që hasin vështirësi në plotësimin e kërkesave për kolateral. Kompanitë që duan të kenë qasjes në këtë dritare duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme: të punësojnë më pak se 250 punonjës, të kenë të paktën një aksionar rezident dhe të operojnë në një sektor me prioritet (mobile, plastikë, pije, ushqim dhe minerale jometalike). Shuma maksimale e kredisë që mund të garantohet është 3 milionë EUR për kredi me afat maturimi deri në 120 muaj. Mbulesa e garancive është deri në 50% të principalit të kredisë, por jo më shumë se 1,000,000 EUR.¹⁹

Konsultimet me palët e interesit nxorën në pah se skema ishte thelbësore për industrinë në të cilat kolaterale janë natyrshëm me vlerë të ulët (p.sh. eksportuesit e frutave të freskëta), krahasuar me industrinë që kërkojnë makineri dhe pajisje më të rënda për të prodhuar (p.sh. metal, dru, etj.). Ajo gjithashtu është shumë tërheqëse për kompanitë e reja në zhvillim me historik të ulët kreditor. Kompanitë që kanë nevojë për financim të shpejtë dhe përballen me nevoja urgjente likuiditeti mund gjithashtu ta konsiderojnë skemën tërheqëse, pasi regjistrimi i një kolaterali mund të jetë një proces i gjatë.

Megjithëse skema ka qenë e suksesshme në misionin e saj për të mbështetur kompanitë që të kenë qasje në financimin e nevojshëm për eksport, dy çështje kryesore mbeten, siç është theksuar në intervistat me informatorët kryesor. Së pari, megjithëse skema zvogëlon rrezikun kreditor për bankat komerciale që japin kredi, normat e interesit shpesh nuk ulen dhe, në disa raste, raportohet se kanë qenë më të larta për përfituesit e FKGK-së sesa për klientët e zakonshëm. Më konkretisht, klientët paguajnë, mesatarisht, një normë interesi prej 7% (përfshirë tarifën bankare) dhe mes 1.5% dhe 2% tarifa administrative nga fondi. Duke pasur parasysh që Kosova ka norma të ulëta të mospagesës (rreth 2%), duket se ekziston hapësirë për përmirësim.

Si pasojë, duket se duhet bërë më shumë për të mos dëmtuar konkurrueshmërinë e kompanive eksportuese, të cilat janë motorë thelbësorë të rritjes për vendin. Rreziku më i ulët i kredive të garantuar për bankat komerciale duhet të reflektohet në normën e interesit që u ngarkohet kompanive përfitues të dritares së eksportit. Për të siguruar këtë, institucionet përkatëse, si Banka Qendrore e Kosovës, mund të rregullojnë normat e interesit dhe tarifën që ngarkojnë bankat komerciale.

¹⁸ Agjencia e Statistikave të Kosovës raportoi 1.59 milion banorë në regjistrimin e popullsisë të prillit 2024.

¹⁹ Shih <https://fondikgk.org/en/export-window/> për më shumë detaje.

Së dyti, një kufizim tjetër i dritares së eksportit të FKGK-së lidhur me Objektivin Strategjik të ngushtimit të deficitit tregtar industrial është se qasja është e kufizuar vetëm për eksportuesit. Për të adresuar edhe anën e importit të deficitit tregtar, mund të konsiderohet që të zgjerohet mbulimi i dritares për disa sektorë kyç shtesë, veçanërisht ata në zinxhirë të vlerës me potencial për zëvendësim të importeve. Kjo mund të ndihmojë në uljen e varësisë nga produktet e huaja.

5.3. KRIJIMI I NJË PROGRAMI TË PUNËSIMI NË SEKTORIN E PRODHIMIT NË KUADËR TË KORNIZËS SË MASAVE AKTIVE TË TREGUT TË PUNËS

Për të krijuar mundësi për punë gjithëpërfshirëse dhe me dinjitet (Objektivi Strategjik 3 i Politikës Industriale), Plani i Veprimit parashikon ndërhyrje në tri fusha kryesore. Një nga to është përmirësimi i kualifikimit dhe certifikimit të fuqisë punëtore teknike si dhe menaxherëve të ndërmarrjeve. Për ta arritur këtë, brenda Planit të Veprimit 2023-2025 u parashikuan shtatë veprime konkrete të politikës. Nga to, katër instrumente të politikës janë zbatuar tashmë (duke përfshirë fillimin e programit për punësimin në prodhim) dhe tri janë zbatuar pjesërisht; shih Tabelën 9.

TABELA 9: STATUSI I ZBATIMIT TË VEPRIMEVE TË POLITIKËS NË KUADËR TË OBJEKTIVIT SPECIFIK 3.1 "PËRMIRËSIMI I KUALIFIKIMIT DHE CERTIFIKIMIT TË FUQISË PUNËTORE TEKNIKE DHE MENAXHERËVE TË NDËRMARRJEVE"

| AKTIVITETET E ZBATUARA | AKTIVITETET E ZBATUARA PJESËRISHT | AKTIVITETET QË NUK JANË ZBATUAR ENDE |
|--|--|--------------------------------------|
| 3.1.1 Zhvillimi i një hulumtimi të plotë për të identifikuar mangësitë e aftësive në tregun e punës së industrisë dhe për të kuptuar sfidat e punëdhënësve në gjetjen e punëtorëve të kualifikuar | 3.1.5 Krijimi i një skeme kreditore për përmirësimin e aftësive në tregun e punës | |
| 3.1.2 Ofrimi i ndihmës financiare për shoqatat e prodhuesve për të menaxhuar këshillat sektoriale të punës | 3.1.6 Mbështetja për hapjen e qendrave jopublike të trajnimit të akredituara me programe për përmirësimin e aftësive në industri. | |
| 3.1.3 Hartimi i ligjit për këshillat industriale | 3.1.7 Mbështetja për hartimin e programeve të trajnimit për zhvillimin e aftësive në industri | |
| 3.1.4 Krijimi i një programi të punësimi në sektorin e prodhimit në kuadër të kornizës së Masave Aktive të Tregut të Punës | | |
| 3.2.1 Hartimi i një analize për të vlerësuar shkallën e informalitetit në punësim sipas aktiviteteve të industrisë | | |
| 3.2.2 Vendosja e një pragu të pagës së jetesës në industri | | |
| 3.3.1 Organizimi i Javës së Grave në Industri | | |
| 3.3.2 Mbështetja e qendrave të karrierës në shkollat e mesme dhe universitetet | | |

| | | |
|---|--|--|
| për të krijuar lidhje bashkëpunuese me shoqatat e industrisë | | |
| 3.3.3 Mbështetja e trajnimit në vendin e punës për gratë dhe të rinjtë | | |

Megjithëse Kosova ka një fuqi punëtore të re dhe dinamike, vendi ka hasur vështirësi në krijimin e aftësive të duhura për të përmbushur nevojat e ekonomisë. Gjatë dekadës së fundit, diplomat universitare janë perceptuar si synimet kryesore të karrierës, gjë që i ka larguar studentët potencialë nga shkollat teknike. Si rezultat, mungesa e aftësive teknike të rëndësishme për industrinë, dhe veçanërisht për prodhimin, ka penguar kompanitë në Kosovë të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Kjo është përkeqësuar nga emigrimi i vazhdueshëm dhe largimi i trurit.

Megjithatë, përpjekjet e fundit për të zvogëluar mospërputhjen mes ofertës dhe kërkesës kanë dhënë rezultate inkurajuese. Për shembull, në vitin 2024, më shumë studentë u angazhuan në trajnime teknike sesa në rrugë karriere universitare. Disa faktorë kanë kontribuar në këtë ndryshim mendësie. Mungesa e aftësive teknike ka përmirësuar fuqinë e negocimit të punonjësve me këto aftësi, dhe madje studentët në programe të mësimit të dyfishtë ose të rinjtë e diplomuar mund të marrin paga shumë më të larta se paga minimale (p.sh. Mes 700 dhe 800 euro për praktikantët në sektorin e drurit, ose 1,000 euro për të diplomuarit në tekstil).

